



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Datë 17.09.2026

**PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSION I UJESJELLESIT TE FSHHATRAVE TE NJESISE ADMINISTRATIVE SYNEJ DHE GOLEM BASHKIA KAVAJE”

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 24 Muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45247130-0 Punime ndërtimi për ujësjellës

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,222,259,376 (nje miliard e dyqind e njezet e dy milion e dyqind e pesedhjetë e nentemije e treqind e shtatedhjetë e gjashtë) lek pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 13,336,163.40 (Trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre presje dyzet) **Euro.**

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 17.09.2026 është 91.65 euro.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjedhjes së fituesit ka përgjedhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar **(jo më shumë se 24 muaj)**. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të vecanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënes të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shenim: Per permbushjen e kriterit te mesiperm operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturate me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vleresimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e larte e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në oferten ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifkohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë koston gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 te ketij ligj, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vleresohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokruimi, duke perfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshiinë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi koston, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5, Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikon e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këto kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin suksess të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të siellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetëm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me përvojën e duhur mund të siellë rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të deshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organizigramen e propozuar

te stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që ne me veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër te tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet ti kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Per të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nenkriteret për operatorët ekonomike pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migësore me miedisin të ricikluara/ eficiente/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësimet të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit e cila tregon jetegjatësinë e objektit, faktin se sa me maksimale të jetë periudha aë përfshin garancinë e vepres e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të vepres dhe marrjen në dorëzim të saj.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit N.162 / 2020 Për Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës – Kanalizimeve Durrës Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kriteria të veçanta të kualifikimit, Pika 2.2.1, 2.2.2, Shtojca 7 e DST-së.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik Kriteria të veçanta të Kualifikimit, të shtojcës 7 e DST-së;
- Licenca e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2/b, 2.3.2/c, 2.3.2/d, 2.3.2 e), 2.3.2/f) të kapacitetit Teknik të Kriteria të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 7 e DST-së.
- Staf i Teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3/c, 2.3.3/d, 2.3.3/g, 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të Kriteria të veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7 e DST-së.

Argumentim: Në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, Autoriteti Kontraktor ka marrë në konsideratë natyrën, objektin, volumin, kompleksitetin teknik dhe kohëzgjatjen e kontratës, si dhe nevojën për të garantuar që operatori ekonomik i kualifikuar të disponojë kapacitetet e nevojshme ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të saj.

Kriteret e përcaktuara në Shtojcën 7 të DST-së janë vendosur në funksion të verifikimit të aftësisë reale të operatorëve ekonomikë për marrjen përsipër dhe realizimin e kontratës, duke synuar njëkohësisht proporcionalitetin e kërkesave me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit.

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar – pikat 2.2.1 dhe 2.2.2 të Shtojcës 7 të DST-së

Kërkesat e përcaktuara në pikat 2.2.1 dhe 2.2.2 janë vendosur me qëllim verifikimin e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit ekonomik e financiar të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Realizimi i kontratës kërkon angazhimin e vazhdueshëm të burimeve financiare për sigurimin e fuqisë punëtore, mjeteve dhe makinerive, materialeve, pajisjeve, furnizimeve dhe shpenzimeve të tjera të domosdoshme për ekzekutimin e punimeve.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor duhet të krijojë bindjen e arsyeshme se operatori ekonomik disponon një kapacitet financiar të përshtatshëm për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës dhe për të siguruar vijueshmërinë e punimeve pa krijuar ndërprerje për shkak të pamundësisë financiare.

Kërkesat për xhiron dhe dokumentacionin financiar nuk synojnë kufizimin e konkurrencës, por shërbejnë si tregues objektivë të aktivitetit ekonomik dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit në raport me përmasat e kontratës që do të marrë përsipër.

Në këtë kuptim, kriteret e pikave 2.2.1 dhe 2.2.2 janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe vlerën e kontratës dhe synojnë reduktimin e riskut të mosrealizimit apo të ndërprerjes së kontratës për shkak të mungesës së kapaciteteve të nevojshme financiare.

2. Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme – pika 2.3.1 e Shtojcës 7 të DST-së

Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1, lidhur me realizimin me sukses të kontratave të mëparshme, është vendosur për të provuar eksperiencën reale teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik në realizimin e punimeve të një natyre të njëjtë ose të ngjashme me objektin e prokurimit.

Përvoja e mëparshme përbën një element të rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë së operatorit ekonomik për të organizuar dhe menaxhuar realizimin e kontratës, për të koordinuar burimet njerëzore dhe teknike dhe për të përballuar problematikat që mund të lindin gjatë ekzekutimit.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e objektit të prokurimit dhe ndërthurjen e disa kategorive të punimeve, eksperiencën në kontrata të mëparshme krijon një garanci të arsyeshme se operatori ekonomik ka realizuar më parë procese pune të krahasueshme dhe disponon njohuritë organizative dhe teknike të nevojshme.

Kriteri nuk synon thjesht evidentimin e ekzistencës formale të kontratave të mëparshme, por provimin se operatori ekonomik ka qenë në gjendje t'i realizojë ato me sukses.

Për rrjedhojë, kërkesa për përvojën e suksesshme është e lidhur ngushtë me natyrën e objektit të kontratës dhe është vendosur për të garantuar një nivel të përshtatshëm sigurie lidhur me aftësinë e operatorit për realizimin cilësor dhe brenda afateve të kontratës objekt prokurimi.

3. Licencat profesionale – pika 2.3.2/a e Shtojcës 7 të DST-së

Kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2/a për disponimin e licencave profesionale përkatëse është vendosur në përputhje me natyrën dhe kategoritë e punimeve që parashikohen të realizohen në kuadër të kontratës.

Licencimi profesional përbën provën se operatori ekonomik është i kualifikuar për ushtrimin e veprimtarisë dhe realizimin e kategorive përkatëse të punimeve, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Kategoritë dhe klasifikimet e licencës të kërkuara në DST janë përcaktuar duke u nisur nga zërat konkretë të preventivit, specifikimet teknike dhe natyra e punimeve që duhet të realizohen dhe, për rrjedhojë, nuk përbëjnë kërkesa të shkëputura nga objekti i kontratës.

Qëllimi i këtij kriteri është që realizimi i punimeve t'i besohet një operatori që disponon aftësinë dhe kualifikimin profesional të nevojshëm për kategoritë konkrete të punimeve, duke garantuar respektimin e standardeve teknike, cilësisë së zbatimit dhe kërkesave të sigurisë.

Për këtë arsye, kërkesa për licencat duhet të konsiderohet e domosdoshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, ndërsa kategoritë dhe nivelet përkatëse duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe vlerën e punimeve që mbulon secila kategori.

4. Staf i teknik – pikat 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3/c, 2.3.3/d, 2.3.3/e, 2.3.3/f, 2.3.3/g dhe 2.3.3/h të Shtojcës 7 të DST-së

Kërkesat lidhur me stafin teknik dhe profesional janë përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, volumin, kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e proceseve të punës që parashikohen në preventiv dhe specifikimet teknike.

Realizimi i objektit të kontratës kërkon jo vetëm disponimin e mjeteve dhe makinerive të përshtatshme, por edhe angazhimin e personelit me formimin, eksperiencën dhe kualifikimet profesionale përkatëse.

Në këtë kuadër, kërkesat e pikave 2.3.3/a–2.3.3/h synojnë të provojnë se operatori ekonomik disponon një strukturë të përshtatshme teknike dhe organizative për realizimin e njëkohshëm dhe të koordinuar të proceseve të ndryshme të punës.

Stafi inxhinierik dhe teknik është i domosdoshëm për drejtimin teknik të punimeve, kontrollin e zbatimit të projektit, respektimin e specifikimeve teknike, organizimin e kantierit, kontrollin e cilësisë, matjet dhe verifikimet, koordinimin e proceseve të punës dhe respektimin e kërkesave të sigurisë.

Po kështu, personeli i specializuar dhe punonjësit e kualifikuar janë të nevojshëm për realizimin praktik të zërave specifike të preventivit, përfshirë punimet e ndërtimit, punimet hidroteknike, montimin dhe testimin e tubacioneve, punimet elektrike, mekanike, topografike, betonimin, armimin, asfaltimin dhe proceset e tjera që parashikohen në objekt.

Numri dhe profilet e personelit të kërkuar duhet të vlerësohen në raport me volumin e punimeve, grafikun e realizimit, shtrirjen e kantierit dhe nevojën për zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të punës.

Për rrjedhojë, kërkesat për stafin teknik nuk janë vendosur thjesht për të provuar numrin e të punësuarve të operatorit ekonomik, por për të garantuar disponueshmërinë reale të burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës.

Këto kritere krijojnë siguri për Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik do të jetë në gjendje të realizojë punimet sipas projektit, preventivit, specifikimeve teknike dhe grafikut të punimeve, pa cenuar cilësinë, afatet dhe sigurinë gjatë zbatimit.

Argumentimi për mosndarjen në lote:

Në mbështetje të nenit 39 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 42 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Autoriteti/Enti Kontraktor, pas analizimit të natyrës, objektit, ndërvlerësive teknike dhe funksionale të punimeve, ka vlerësuar që procedura me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të Njësisë Administrative Fushë-Kuqe – Thumanë, Bashkitë Kurbin dhe Krujë” të zhvillohet si një kontratë e vetme dhe të mos ndahet në lote.

Objekti i kontratës përbën një sistem të vetëm dhe të integruar të furnizimit me ujë, i cili përfshin linjën e dërgimit, ndërtimin e depos së re 2,000 m³, linjat kryesore të rrjetit të ujësjellësit të Fushë-Kuqes, Thumanës dhe Gramëzit, rrjetet shpërndarëse në zonat përkatëse, pusetat dhe pajisjet hidraulike, instalimet elektrike dhe sistemet e kontrollit, si dhe rikthimin e shtresave rrugore të prekura nga punimet. Preventivi i objektit i paraqet këto komponentë si pjesë të të njëjtit investim dhe të të njëjtit sistem funksional.

Nënobjektet kanë varësi të drejtpërdrejtë hidraulike dhe teknologjike ndërmjet tyre. Linja e dërgimit lidhet me depon 2,000 m³, depoja lidhet me linjat kryesore dhe këto të fundit furnizojnë rrjetet shpërndarëse. Për rrjedhojë, funksionimi dhe marrja në dorëzim e një komponenti kushtëzohen nga përfundimi dhe përputhshmëria teknike e komponentëve të tjerë. Ndarja e tyre në kontrata të veçanta do të krijonte ndërfaqe të shumta teknike ndërmjet kontraktorëve dhe do të rriste rrezikun e mospërputhjeve në kuota, lidhje, presione, rakorderi, testime dhe vënie në funksion të sistemit.

Preventivi parashikon gjithashtu një zinxhir të integruar punimesh, duke filluar nga gjurmimet dhe përgatitja e traseve, vendosja e tubacioneve dhe rakorderive, realizimi i strukturave betonarme, mbushja dhe ngjeshja e kanaleve, deri te rikthimi i stabilizantit, binderit dhe asfaltobetonit. Për shembull, vetëm në linjën kryesore të Fushë-Kuqes parashikohen 11,378.80 m³ gjurmim mekanik kanali, 7,781.20 m³ mbushje me çakëll e gur gurorë dhe mijëra metra katrorë shtresa stabilizanti. Në linjën kryesore të Gramëzit parashikohen gjithashtu mbushje, stabilizant, binder, asfaltobeton dhe punime betonarmeje.

Ndarja e këtyre proceseve apo nënobjekteve në kontrata të ndryshme do të krijonte varësi kontraktuale, pasi një kontraktor nuk do të mund të përfundonte punimet e tij pa realizimin e punimeve të kontraktorit tjetër. Kjo do të rriste rrezikun e vonësive, pretendimeve reciproke për përgjegjësi, kostove shtesë të koordinimit dhe vështirësive në përcaktimin e përgjegjësisë për defektet gjatë testimit dhe periudhës së garancisë.

Gjithashtu, objekti përfshin elemente hidraulike, elektrike dhe elektronike që duhet të integrohen në të njëjtin sistem, përfshirë pajisjet e kontrollit dhe RTU-në për komunikimin me sistemin ekzistues SCADA. Për këtë arsye është e nevojshme që përgjegjësia për instalimin, integrimin, testimin dhe vënien në punë të sistemit të jetë e unifikuar dhe e identifikueshme te një kontraktor i vetëm.

Mosndarja në lote mundëson gjithashtu hartimin dhe zbatimin e një grafiku unik të punimeve, organizimin e fronteve paralele, përdorimin e koordinuar të makinerive dhe personelit, furnizimin e unifikuar me materiale dhe kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë. Në të kundërt, kontraktimi i veçantë i linjës së dërgimit, depos, linjave kryesore dhe rrjeteve shpërndarëse do ta kushtëzonte progresin e secilit kontraktor nga realizimi i kontratave të tjera dhe do të shtonte rrezikun e mosrespektimit të afatit të përgjithshëm të investimit.

Ky vlerësim është në përputhje edhe me qëllimet e ligjit nr. 162/2020 për rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të prokurimit, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e kostove procedurale, duke ruajtur njëkohësisht konkurrencën, trajtimin e barabartë, proporcionalitetin dhe transparencën.

Për më tepër, natyra e objektit lidhet drejtpërdrejt me sektorin e ujit, për të cilin neni 62 i ligjit nr. 162/2020 përfshin ofrimin ose përdorimin e rrjeteve për prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm. Në çdo rast, pavarësisht regjimit procedural që zbatohet për kontratën sektoriale, Autoriteti/Enti Kontraktor ka kryer këtë analizë për të dokumentuar se mosndarja nuk synon kufizimin artificial të konkurrencës, por buron nga uniteti teknik dhe funksional i veprës, ndërvarësia e nënobjekteve dhe nevoja për përgjegjësi të vetme për performancën përfundimtare të sistemit.

Në aspektin e zbatimit të punimeve, është marrë në konsideratë edhe VKM nr. 448, datë 31.07.2025, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”, e cila rregullon organizimin dhe funksionimin e kantierit dhe përgjegjësitë e aktorëve

të zbatimit. Organizimi i integruar i këtij investimi nën një kontratë të vetme mundëson përcaktim më të qartë të përgjegjësisë së zbatuesit, koordinim më efektiv me drejtuesin teknik dhe mbikëqyrësin, menaxhim të unifikuar të kantierit dhe kontroll më efektiv të zbatimit të projektit.

Për sa më sipër, Autoriteti/Enti Kontraktor vlerëson se ndarja e kësaj procedure në lote nuk është teknikisht dhe funksionalisht e përshtatshme dhe nuk do t'i shërbente realizimit eficient të objektit. Zhvillimi i procedurës si një kontratë e vetme garanton koordinim të plotë të punimeve, përgjegjësi të unifikuar për cilësinë dhe funksionimin e sistemit, respektimin e grafikut të punimeve dhe reduktimin e rreziqeve teknike, kontraktuale dhe administrative gjatë zbatimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë sipas nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare;** ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese

fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financa”; Ligji Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Në keto kushte, vleresojmë të kërkojmë kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Në rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi leshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Në rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi **të përshtatshëm** cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund

të përcaktojë kriteret tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kerkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

• Kategoria NP- 1 Punime gjurmimi në tokë	Klasifikimi C
• Kategoria NP- 4 Rruge, autostrada, ura, mbikalime...	Klasifikimi B
• Kategoria NP- 7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Klasifikimi G
• Kategoria NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit	Klasifikimi A
• Kategoria NS- 9 Punime strukturore speciale	Klasifikimi C
• Kategoria NS-14 Impiante të brendshme elektrike telefonike etj...	Klasifikimi B
• Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike	Klasifikimi C

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme** njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në

nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

NP-1 – Punime gërmimi në tokë – Klasifikimi C

Kërkesa për kategorinë NP-1, klasifikimi C, është e lidhur drejtpërdrejt me volumin dhe natyrën e punimeve të gërmimit të parashikuara në preventiv. Për realizimin e linjave të ujësjellësit kërkohet hapja e kanaleve për vendosjen e tubacioneve në një shtrirje të konsiderueshme territoriale. Konkretisht, vetëm në preventivin e linjës unazore Qerret janë parashikuar 722 m³ gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, 812 m³ gërmim kanalesh në tokë të fortë dhe 7,260.70 m³ gërmim dheu me ekskavator në kanale.

Edhe në segmentet e tjera të objektit parashikohen punime të së njëjtës natyre, çka tregon se gërmimet nuk janë punime sporadike apo ndihmëse, por një komponent thelbësor për realizimin e rrjetit të ujësjellësit. Për këtë arsye, kërkesa për NP-1/C është në përputhje me zërat dhe volumin e punimeve të preventivit.

NP-4 – Rrugë, autostrada, ura, mbikalime etj. – Klasifikimi B

Kërkesa për NP-4, klasifikimi B, argumentohet me faktin se shtrirja e tubacioneve ndërhyr në infrastrukturën ekzistuese rrugore dhe, pas vendosjes së tyre, kërkon rikthimin e shtresave të rrugës në gjendjen e parashikuar në projekt.

Preventivi përmban shprehimisht zëra për prerjen e asfaltit, si dhe për realizimin e shtresave rrugore. Për linjën kryesore të shpërndarjes janë parashikuar 1,294 m² shtresë binderi 6 cm, 1,294 m² shtresë asfaltobetoni 4 cm dhe 1,200 ml prerje asfalti me disk. Ndërsa vetëm në linjën unazore të rrjetit shpërndarës Qerret rezultojnë 6,317 ml prerje asfalti me disk.

Në preventiv gjenden gjithashtu punime për bordura, trotuare dhe prerje të rrugëve prej betoni; në segmente të tjera evidentohen, ndër të tjera, 217 ml prerje rruge betoni dhe 610 ml prerje asfalti. Pra, ndërhyrja dhe rehabilitimi i shtresave rrugore është pjesë reale e objektit, duke justifikuar kërkesën për NP-4/B.

NP-7 – Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje – Klasifikimi G

Kategoria NP-7 është kategoria themelore dhe më drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës, pasi vetë objekti është rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit. Preventivi përmbledhës parashikon ndërtimin e linjës së dërgimit, linjës së furnizimit, depos së re 6,000 m³ në Agonas, linjës kryesore të shpërndarjes, linjës unazore dhe një numri të madh linjash shpërndarjeje sipas zonave.

Volumi i punimeve hidraulike është i konsiderueshëm. Vetëm në një nga segmentet e linjës kryesore parashikohen tuba PE 100 RC të diametrave DN 90, 125, 160, 200, 400 dhe 450 mm, ku vetëm DN 400 është 1,157 ml dhe DN 450 është 2,879 ml. Në linjën unazore Qerret parashikohen ndër të tjera 2,721 ml tub PE DN 200 dhe 906 ml tub PE DN 315, krahas tubacioneve të diametrave të tjerë.

Preventivi përmban gjithashtu rakorderi, fllanxha, pjesë çmontuese, saraçineska, matësa uji, ajrues dhe valvula kontrolli/reduktimi presioni.

Për rrjedhojë, NP-7/G lidhet drejtpërdrejt me pjesën kryesore të kontratës dhe me shtrirjen e konsiderueshme të rrjetit të ujësjellësit.

NP-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit – Klasifikimi A

Për NP-12/A, argumentimi duhet bërë më me kujdes. Nga preventivi rezultojnë punime që lidhen me sistemimin dhe mbrojtjen e territorit, ndërhyrje në sipërfaqe dhe elemente të rehabilitimit, përfshirë punime të gjelbërimit. Në pjesën e depos, për shembull, është parashikuar mbjellje bari në skarpat, 1,200 m², si dhe vendosje shkurresh dekorative. Gjithashtu objekti, si infrastrukturë e furnizimit me ujë të pijshëm, përmban masa dhe punime për mbrojtjen higjieno-sanitare të veprës. Megjithatë, nga zërat e preventivit që kam shqyrtuar, NP-12 nuk rezulton aq drejtpërdrejt dhe fort e mbështetur sa NP-1, NP-4 dhe NP-7. Prandaj, nëse kjo kategori duhet mbajtur patjetër në kriteret e kualifikimit, rekomandoj që argumentimi të mbështetet te zërat konkretë të punimeve mjedisore dhe jo thjesht te fakti që objekti është ujësjellës.

NS-9 – Punime strukturore speciale – Klasifikimi C

Kërkesa për NS-9/C lidhet veçanërisht me ndërtimin e depos së re me kapacitet 6,000 m³, e cila përbën një strukturë të rëndësishme betonarme dhe kërkon realizimin e elementeve konstruktive me karakteristika specifike.

Preventivi parashikon për rezervuarin 1,052 m³ beton C30/37 për pllakën, ndërsa për elementet e tjera parashikohen 582 m³ beton C30/37 për muret me trashësi 40 cm, 419 m³ për muret me trashësi 50 cm, 345 m³ për soletën, 86 m³ për trarët, 83 m³ për kolonat dhe 75 m³ për krijimin e pjerrësive.

Krahas kësaj, preventivi përmban trarë metalikë IPE, dysHEME metalike, waterstop dhe hidroizolim të posaçëm të depos për ujë të pijshëm. Për hidroizolim të brendshëm të depos janë parashikuar 1,445 m² shtresë me bazë epoxy për ujë të pijshëm, si dhe shtresa poliuretani.

Pra, kërkesa për NS-9/C argumentohet me kompleksitetin konstruktiv të depos 6,000 m³ dhe elementeve të tjera strukturore të veprës, si dhe me volumin e konsiderueshëm të punimeve betonarme dhe speciale që kërkohen për realizimin e saj.

NS-14 – Impiante të brendshme elektrike, telefonike etj. – Klasifikimi B

Kategoria NS-14/B lidhet drejtpërdrejt me instalimet elektrike, të komandimit, kontrollit, monitorimit dhe automatizimit të parashikuara në preventiv.

Preventivi përmbledhës përfshin në mënyrë të veçantë “Ndërtimi i sistemit SCADA”. Gjithashtu, në preventivin e depos parashikohet një pajisje elektronike memorizuese dhe kontrolluese me modul komunikimi në distancë (RTU), e përshtatshme për komunikim me programin SCADA ekzistues, si dhe kuadër elektrik, linja kabllorë, përcjellës mbrojtës, zbarra tokëzimi, sistem rrufepritës dhe ndriçim.

Kjo kategori nuk kërkohet pra vetëm për instalime të zakonshme ndriçimi, por për një sistem funksional elektrik, komandimi, kontrolli dhe transmetimi të të dhënave, të domosdoshëm për monitorimin dhe funksionimin e rrjetit të ujësjellësit. Për këtë arsye NS-14/B është e lidhur me zërat konkretë të preventivit.

NS-18 – Punime topogjeodezike – Klasifikimi C

Nga ana teknike, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme lineare: përfshin linja dërgimi, furnizimi, linjë kryesore, unazë dhe një numër të madh zonash shpërndarjeje. Realizimi i saktë i

një rrjeti të tillë kërkon në praktikë piketimin e gjurmëve, përcaktimin e kuotave dhe koordinatave, kontrollin e pozicionimit të tubacioneve dhe rilevimin përfundimtar të veprës.

Kërkesa për njehsimin/ekuivalentimin e licencave profesionale të operatorëve ekonomikë të huaj është përcaktuar me qëllim verifikimin e ekuivalencës së kategorive dhe klasifikimeve profesionale të lëshuara nga shteti i origjinës me sistemin e licencimit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me VKM nr. 42, datë 16.01.2008. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me përshtatshmërinë profesionale të operatorit për realizimin e punimeve objekt prokurimi dhe është në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 dhe rregullat e prokurimit publik. Kërkesa zbatohet në mënyrë të barabartë, duke njohur licencat e lëshuara në shtetin e origjinës së operatorit të huaj, pasi të jetë kryer procedura përkatëse e njohjes/njehsimit sipas legjislacionit shqiptar. Mosplotësimi i këtij kriteri për kategoritë dhe klasifikimet e kërkuara përbën mosplotësim të kriterit të veçantë të kualifikimit

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë SSH EN ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme/ ose ekuivalent objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë SSH EN ISO 14001:2015 ose ISO 14001:2026 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, e vlefshme/ ose ekuivalent objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë SSH EN ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, e vlefshme/ ose ekuivalent objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

1. Certifikatë SSH EN ISO 9001 - 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë ISO 9001:2015, me objekt në përputhje me natyrën e kontratës, argumentohet me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e punimeve të parashikuara në preventiv, për të cilat kërkohet kontroll i vazhdueshëm i cilësisë së materialeve, proceseve të zbatimit dhe punimeve të përfunduara.

Objekti përfshin ndërtimin e linjave të dërgimit dhe furnizimit, ndërtimin e depos së re me kapacitet 6,000 m³, linjën kryesore dhe unazore të shpërndarjes, një numër të madh linjash shpërndarëse sipas zonave, si dhe ndërtimin e sistemit SCADA.

Preventivi përmban punime me kërkesa të larta teknike dhe cilësore, ndër të cilat vendosje tubacionesh PE 100 RC të diametrave të ndryshëm, rakorderi, saraçineska dhe pajisje kontrolli. Vetëm në një segment të linjës kryesore parashikohen 1,157 ml tub PE DN 400 dhe 2,879 ml tub PE DN 450, krahas diametrave të tjerë.

Në të njëjtën kohë, ndërtimi i rezervuarit 6,000 m³ përfshin sasi të konsiderueshme betoni C30/37, konkretisht 582 m³ për muret me trashësi 40 cm, 419 m³ për muret 50 cm, 345 m³ për soletën, 86 m³ për trarët dhe 83 m³ për kolonat. Këto punime kërkojnë kontroll të materialeve, përputhshmërisë me specifikimet, procedurave të punës, inspektimeve, provave dhe dokumentimit teknik.

Për këtë arsye, kërkesa për ISO 9001:2015 kerkohet pasi sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori të ketë procedura të dokumentuara për kontrollin e proceseve të zbatimit, materialeve dhe rezultateve përfundimtare, në përputhje me kërkesat teknike të kontratës.

2. Certifikatë SSH EN ISO 14001:2015 ose ISO 14001:2026 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
Kërkesa për certifikimin e sistemit të menaxhimit të mjedisit argumentohet nga ndikimet mjedisore që mund të krijohen gjatë realizimit të punimeve të parashikuara në preventiv, sidomos për shkak të gjurmimeve masive, transportit të dherave dhe materialeve, ndërhyrjeve në rrugë, gjenerimit të mbetjeve nga prishjet dhe nevojës për rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura.

Preventivi përmban volume të konsiderueshme gjurmimesh. Vetëm për linjën unazore Qerret janë parashikuar 722 m³ gjërmim kanalesh në tokë të zakonshme, 812 m³ në tokë të fortë dhe 7,260.70 m³ gjërmim mekanik me ekskavator.

Po kështu, në preventivin e depos së re është parashikuar transporti i 9,861 m³ materialeve ndërtimi dhe dheu, çka tregon nevojën për administrimin e kontrolluar të materialeve të dala nga gjërimi dhe minimizimin e ndikimeve nga transporti, pluhurat, ndotja dhe depozitimi.

Punimet ndërhyjnë gjithashtu në infrastrukturën ekzistuese rrugore. Vetëm në një segment parashikohen 6,317 ml prerje asfalti, ndërsa në segmente të tjera parashikohen prerje rruge betoni, prerje asfalti, trotuare dhe bordura.

Preventivi përmban edhe masa të drejtpërdrejta rehabilituese të territorit, si mbjellje bari në skarpat në një sipërfaqe prej 1,200 m², çka konfirmon se komponenti i rehabilitimit mjedisor është pjesë e punimeve.

Në këto kushte, sistemi ISO 14001 është i lidhur drejtpërdrejt me nevojën që operatori të ketë procedura për identifikimin dhe administrimin e aspekteve mjedisore, menaxhimin e mbetjeve, kontrollin e ndotjes, administrimin e dherave dhe materialeve të dala nga gërmimi, si dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga punimet.

Për rrjedhojë, kërkesa është proporcionale me natyrën dhe përmasat e objektit dhe synon minimizimin e ndikimit të punimeve mbi mjedisin gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

3. Certifikatë SSH EN ISO 45001:2018 ose 45001:2023 standardi i përditësuar – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Kërkesa për ISO 45001 është veçanërisht e justifikuar nga natyra e punimeve dhe niveli i risqeve profesionale që paraqet realizimi i objektit.

Preventivi përmban punime gërmimi në kanale, përfshirë punë në tokë të zakonshme, tokë të fortë dhe gërmime mekanike me ekskavator, të cilat sjellin rreziqe të lidhura me shembjen e skarpateve, punën pranë makinerive të rënda, hyrjen dhe daljen në kanale dhe lëvizjen e materialeve. Vetëm në një segment parashikohen mbi 8,700 m³ punime gërmimi të llojeve të ndryshme.

Gjithashtu, për ndërtimin e depos 6,000 m³ parashikohen punime masive betonarme, hekur betoni, struktura metalike dhe punime me skela. Preventivi përmban, ndër të tjera, 80 ton hekur betoni Ø6–10 mm, 255 ton hekur betoni Ø>12 mm dhe 1,200 m² skela metalike deri në 10 m, të cilat krijojnë rreziqe të konsiderueshme për punonjësit gjatë montimit, ngritjes së materialeve dhe punimeve në lartësi.

Rreziqe të tjera krijohen nga punimet elektrike dhe sistemet e kontrollit. Preventivi përfshin instalime elektrike, kablo, tokëzim, rrufepritës, kuadro komandimi dhe sistem SCADA, të cilat kërkojnë procedura të posaçme sigurie dhe personel të trajnuar për shmangien e rrezikut elektrik. Për këtë arsye, certifikimi sipas ISO 45001 lidhet drejtpërdrejt me nevojën që operatori ekonomik të ketë një sistem të dokumentuar për identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e tyre, zbatimin e masave parandaluese, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, trajnimin e personelit dhe administrimin e incidenteve në kantier.

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ Tuba Ujësjiellësi PE
- ✓ Tuba Gize
- ✓ Rakorderi Gize
- ✓ Saracineska Gize
- ✓ Matesa uji multijet
- ✓ Matës Uji Induktiv (EFM)
- ✓ Sistem SCADA
- ✓ RTU

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-

mail,   b  site, e nevojshme p  r Autoritetin Kontraktor n   rast verifikimi nga ana e tij, si dhe t   jet   e vlefshme deri n   realizimin e plot   t   punimeve. N   rast t   disponimit t   autorizimit t   prodhuesit n   gjuh   t   huaj, ky dokument t   paraqitet i p  rkthyer dhe i noterizuar n   gjuh  n zyrtare shqipe.

- Katalogun / et ose fragmente t   katalogut/eve e prodhuesit / ve p  r list  n e m  sip  rme t   artikujve n   t   cil  t t   tregohen dhe t   specifikohen qart   materialet q   do t   ofrohen. **Sh  nim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet t   tregojn   leht  sisht dhe qart   q   jan   pjes   katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i p  rkasin.

N   rast bashkimi t   operator  ve ekonomik  , secili operator ekonomik duhet t   dor  ztoj   dokumentat e m  sip  rme sipas artikujve q   do t   marr   p  rsip  r t   furnizoj   referuar preventivit t   objektit t   prokurimit dhe kontrat  s s   bashk  punimit t   n  nshkruar.

Sh  nim: T   gjitha normat dhe standartet e k  rkuara n   specifikimet teknike t   publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t   i referohen edhe ekuivalenteve t   tyre, standarteve shqiptare SSH t   miratuara nga Drejtoria e P  rgjithshme e Standartizimit DPS, n   ato raste kur k  to standarte jan   unifikuar nga kjo Drejtori.

d) P  r mat  sat e ujit multijet

- Operatori Ekonomik duhet t   paraqes   certifikat   ose deklarat   nga prodhuesi / distributori i autorizuar q   v  rteton se standarti i prodhimit t   matesave t   ujit   sht   sipas OIML R49 / ekuivalente me t  , sipas rekomandimeve t   Organizat  s Internacionale t   Metrologjis   Ligjore.
- Operatori Ekonomik duhet t   paraqes   certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me t  , sipas p  rcaktimeve t   Ligjit Nr. 9875 dat   14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 dat   21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

e) RTU

- Operatori Ekonomik duhet t   paraqes   certifikat   p  r **sigurin   kibernetike IEC62443-4-2** p  r automatizimin industrial dhe sistemet e kontrollit p  r nj  sin   e komunikimit dhe d  rgimit t   t   dh  nave RTU.

f) Mat  s Uji Induktiv (EFM)

- Operatori Ekonomik duhet t   paraqes   certifikaten e aprovimit per uje te pijshem nga organizma te akredituar
- Operatori Ekonomik duhet t   paraqes   certifikate CE

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve eshte vler  suar pasi n   objekt kemi t   b  jm   me materiale (artikuj) q   do t   vendosen n   vep  r, bazuar n   dispozitat e sip  rcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 t   VKM-s   Nr.285 dat   19.05.2021 “P  r Miratimin e Rregullave t   Prokurimit Publik”, duhet q   k  to artikuj t   plot  sojn   parametrat dhe standartet e k  rkuara n   specifikimet

teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë autorizim të prodhuesit ose distributorit të autorizuar dhe katalogët teknikë për materialet dhe pajisjet kryesore është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me zërat konkretë të preventivit.

Objekti përfshin ndërtimin e linjave të dërgimit dhe furnizimit, depos së re 6,000 m³, linjës kryesore dhe unazore, linjave të shpërndarjes dhe sistemit SCADA. Pra, një pjesë thelbësore e kontratës konsiston në furnizimin dhe instalimin e materialeve dhe pajisjeve hidraulike dhe elektronike që duhet të funksionojnë si një sistem i integruar.

Tuba ujësjellësi PE- Kërkesa për dokumentacion prodhuesi për tubat PE është plotësisht e mbështetur nga preventivi. Në një nga linjat kryesore parashikohen, ndër të tjera, tuba PE 100 RC DN 90, DN 125, DN 160, DN 200, DN 400 dhe DN 450, ku vetëm DN 400 është 1,157 ml dhe DN 450 2,879 ml.

Në linjën unazore parashikohen gjithashtu 2,721 ml tub PE 100 RC DN 200, 906 ml DN 315, si dhe diametra të tjerë.

Për shkak të sasive të mëdha dhe rolit që tubacionet kanë në jetëgjatësinë, rezistencën ndaj presionit dhe funksionimin e rrjetit, është e arsyeshme që AK të kërkojë dokumentacion që identifikon qartë prodhuesin, origjinën dhe karakteristikat teknike të produktit të propozuar. Katalogu shërben pikërisht për verifikimin se diametri, materiali, klasa e presionit dhe karakteristikat e produktit të ofertuar përputhen me preventivin dhe specifikimet teknike.

Tuba gize, rakorderi gize dhe saraçineska gize

Edhe këto artikuj janë të parashikuar në mënyrë të konsiderueshme në preventiv. Për depon e re gjenden tuba gize me flanaxha DN 500, DN 300 dhe DN 100 me presion PN 16, si dhe pjesë çmontuese.

Preventivi përfshin gjithashtu brryla dhe rakorderi gize DN 100 dhe DN 500, ndërsa në pjesët e tjera të rrjetit gjenden adaptorë, Tee, reduksione dhe pjesë të tjera lidhëse.

Janë parashikuar konkretisht saraçineska gize flutur DN 300, DN 350 dhe DN 500 PN 16, përkatësisht edhe saraçineska me volant dhe me aktuator në segmente të ndryshme të rrjetit.

Këto elemente punojnë nën presion dhe duhet të jenë të përshtatshme me diametrat, presionet dhe mënyrat e bashkimit të tubacioneve të projektuara. Për këtë arsye, kërkesa për autorizim prodhuesi/distributori dhe katalog teknik është e lidhur me nevojën që AK të verifikojë

paraprkisht që produktet e propozuara janë reale, të identifikueshme, të furnizueshme dhe teknikisht të përshtatshme për sistemin.

Matësit e ujit multijet

Matësit multijet janë elemente të rastësishme të preventivit, përsëriten në shumë zona të rrjetit shpërndarës dhe në sasi të konsiderueshme.

Në zonën nr. 1 parashikohen 37 copë matësa multijet DN 1/2", ndërsa në zona të tjera parashikohen kombinime DN 1/2", 1" dhe 2". Në një zonë tjetër parashikohen 108 matësa DN 1/2" dhe 3 matësa DN 2".

Vetë preventivi përcakton për këta matësa karakteristika teknike konkrete: fushë e thatë, R160, sipas EN 14154 dhe me certifikatë MID.

Prandaj katalogu dhe dokumentacioni i prodhuesit janë të nevojshëm për të verifikuar paraprkisht që matësi konkret i propozuar ka tipologjinë, diametrin, klasën metrologjike dhe standardet e kërkuara.

Matës Uji Induktiv – EFM

Preventivi parashikon gjithashtu një numër matësish induktivë në pika të ndryshme të sistemit. Për depon është parashikuar matës uji induktiv DN 500, PN 16, ndërsa në linjën e dërgimit është parashikuar matës induktiv DN 350 PN 16.

Në linja të tjera gjenden matës induktivë DN 100, DN 125, DN 150 dhe DN 200, në disa raste në disa njësi.

Duke qenë pajisje matëse që integrohen në sistemin hidraulik dhe duhet të përputhen me diametrin, presionin nominal dhe sistemin e monitorimit, është e justifikuar kërkesa për katalog teknik dhe provueshmëri të origjinës/prodhuesit.

Sistemi SCADA dhe RTU

Këtu lidhja me preventivin është shumë e fortë. Preventivi përmbledhës ka një zë të veçantë “Ndërtimi i sistemit SCADA”.

Në preventivin e posaçëm të SCADA-s janë parashikuar ndër të tjera: program SCADA; modem komunikimi; dhënës niveli piezometrik; pajisje elektronike për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave – RTU; programimi i pajisjeve elektronike.

Në preventiv parashikohen 25 RTU për komunikim në distancë me programin ekzistues SCADA të SHRUK Durrës SH.A.

Për rrjedhojë, këto pajisje duhet të jenë teknikisht të ndërveprueshme me njëra-tjetrën dhe me sistemin ekzistues. Pikërisht për këtë arsye kërkesa për autorizim të prodhuesit/distributorit dhe

katalog teknik është e justifikuar, pasi i mundëson AK-së të verifikojë origjinën, karakteristikat, kompatibilitetin dhe aftësinë e integritetit të pajisjeve të propozuara.

Matësat e ujit multijet – MID dhe OIML R49

Në disa zona artikulli është formuluar: “Matës uji multijet ... sipas EN 14154 me certifikatë MID, R160”. E njëjta kërkesë përsëritet në shumë zona të rrjetit, përfshirë 130 copë në një zonë, 83 copë në një tjetër dhe sasi të tjera të konsiderueshme.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së aprovimit MID për matësat e ujit multijet është vendosur në përputhje të drejtpërdrejtë me karakteristikat teknike të artikullit të parashikuar në preventiv. Matësat përbëjnë instrumente matëse të prurjes dhe konsumit të ujit dhe rezultatet e tyre përdoren për përcaktimin sasior të konsumit. Për këtë arsye kërkohet dokumentacioni që provon se instrumenti i propozuar përmbush kërkesat metrologjike të përcaktuara për produktin dhe është i përshtatshëm për funksionin e parashikuar.

RTU – IEC 62443-4-2 dhe deklaratat e konformitetit

Nevoja për RTU është e mbështetur në preventiv. Pajisja përshkruhet si pajisje elektronike për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave, dhe preventivi parashikon gjithashtu programimin e pajisjeve.

Për më tepër, një tjetër zë e përcakton RTU-në si pajisje me modul komunikimi në distancë, e përshtatshme për komunikim me programin SCADA ekzistues të SHRUK Durrës SH.A.

Pajisja të plotësojë kërkesa të përshtatshme për sigurinë, besueshmërinë e komunikimit dhe integritetin në sistemin industrial të kontrollit, pasi RTU-ja do të transmetojë të dhëna dhe komanda ndërmjet objekteve të rrjetit dhe sistemit qendror SCADA.

Referuar preventivit, RTU-ja është një pajisje elektronike për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin në distancë të të dhënave, e integruar me sistemin SCADA. Për këtë arsye është e nevojshme që pajisja e propozuar të plotësojë kërkesat e sigurisë dhe konformitetit të përcaktuara në specifikimet teknike, me qëllim garantimin e komunikimit të sigurt, funksionimit të qëndrueshëm dhe kompatibilitetit me sistemin e automatizimit dhe kontrollit.”

Matësi i ujit induktiv (EFM) – aprovim për ujë të pijshëm dhe CE

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e pajisjes në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm. Preventivi përfshin matësa induktive me diametra të ndryshëm, përfshirë DN 500 PN 16, DN 350 PN 16, DN 100, DN 125, DN 150 dhe DN 200.

Për këtë arsye, kërkesa për aprovim për përdorim në ujë të pijshëm mund të argumentohet me funksionin konkret të pajisjes: matësi do të instalohet në një sistem që transporton dhe shpërndan ujë të destinuar për konsum njerëzor. Materialet dhe pjesët e pajisjes që janë në kontakt me ujin duhet të jenë të përshtatshme për këtë përdorim dhe të mos cenojnë karakteristikat higjieno-sanitare të ujit.

Në të njëjtën mënyrë, kërkesa për CE, kur zbatohet për pajisjen konkrete dhe është përcaktuar në specifikimet teknike, synon të provojë konformitetin e pajisjes së propozuar me kërkesat përkatëse të produktit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën **80 (tetedhjetë)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 2 (dy) |
| - Inxhinier Elektrik | 2 (dy) |
| - Inxhinier Mekanik | 1 (nje) |
| - Inxhinier Hidroteknik | 2 (dy) |
| - Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik | 1 (nje) |
| - Inxhinier Automatizimi, i certifikuar për Software programimi PLC dhe SCADA | 1 (një) |
| - Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e

dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Elektronik	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi, Profili Gjeoteknik	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
-Inxhinier Gjeomatik	1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe te figuroje ne Listepagesa per te pakten 3 muajt e Fundit.

*** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

❖ *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

- e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	4 (kater)
- Teknik Topograf	1 (nje)
- Teknik Hidroteknik	1 (nje)

- Hidraulik 7 (shtate)
- Karpentierë 5 (pese)
- Hekurkthyes 5 (pese)
- Betonues 6 (gjashte)
- Saldator 2 (dy)
- Montator 2 (dy)
- Hidroizolues 4 (kater)
- Elektricist 3 (tre)
- Murator 5 (pese)
- Punëtorë te thjeshte 10 (dhjete)
- 2 (dy) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe certificate aftesimit profesional (CAP), leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Për specialistët e mësipërm (me përjashtim të punonjësve shoferë) të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- 3 (tre) Eskavatoristë
- 3 (tre) Automakinist
- 2 (dy) Buldozerist

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve*

të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; **dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kriteri për disponimin mesatar të të paktën 80 (tetëdhjetë) punonjësve për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit është vendosur në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 4 dhe pika 6, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, sipas të cilave kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin, natyrën, vlerën dhe aftësinë zbatuese të kontratës, ndërsa për kontratat e punëve publike autoriteti kontraktor mund të kërkojë fuqinë minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit.

Numri minimal i kërkuar është përcaktuar duke marrë në konsideratë përmasat dhe shtrirjen e objektit, shumëllojshmërinë e proceseve teknologjike dhe volumin e zërave të preventivit. Objekti përfshin linja dërgimi e furnizimi, depo uji 6 000 m³, linjë kryesore dhe unazore shpërndarjeje, linja shpërndarjeje në mbi 20 zona dhe sistemin SCADA.

Preventivi parashikon volume të konsiderueshme gërmimesh, ku vetëm në segmente të veçanta evidentohen mijëra metra kub gërmime mekanike dhe manuale; volume të konsiderueshme

transporti dherash; mijëra metra linearë tubacionesh PE dhe gize; punime për rakorderi dhe pajisje hidraulike; si dhe mijëra metra katrorë stabilizant, binder dhe asfaltobeton për rikthimin e sipërfaqeve rrugore.

Paralelisht, ndërtimi i depos së re 6 000 m³ përbën një front pune të veçantë, ku vetëm për armaturën janë parashikuar 80 ton hekur Ø6–10 mm dhe 255 ton hekur Ø>12 mm, si dhe 1 200 m² skela metalike, krahas volumeve të konsiderueshme të betonit për pllakën, muret, soletën, trarët dhe kolonat e rezervuarit.

Për shkak të shtrirjes së veprës dhe proceseve të ndryshme teknologjike, zbatimi kërkon mobilizimin e njëkohshëm të fuqisë punëtore për punimet e gërmimit dhe mbushjes, transportin, montimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidraulike, punimet betonarme, rikthimin e shtresave rrugore, instalimet elektrike dhe sistemin e automatizimit/SCADA, si dhe punimet ndihmëse dhe masat e sigurimit teknik. Këto procese nuk mund të realizohen nga i njëjti grup punonjësish në të njëjtën kohë, ndaj realizimi brenda afateve kontraktuale kërkon organizimin e disa fronteve të punës.

Kërkesa lidhet gjithashtu me detyrimet e zbatuesit të punimeve sipas ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 448, datë 31.07.2025, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”. Rregullorja kërkon që zbatuesi të sigurojë në kantier punëmarrës të aftë dhe punonjës të kualifikuar, si dhe e ngarkon atë dhe drejtuesit teknikë me përgjegjësinë për masat organizative, teknike, teknologjike dhe të sigurisë që garantojnë realizimin e punimeve.

Për rrjedhojë, kërkesa për një mesatare prej të paktën 80 punonjësish vlerësohet e nevojshme për të provuar kapacitetin real organizativ dhe operacional të operatorit për realizimin e kontratës dhe është e lidhur me natyrën, përmasat dhe volumin e punimeve, pa pasur qëllim kufizimin e konkurrencës. Periudha 3-mujore dhe verifikimi përmes vërtetimit të administratës tatimore dhe listëpagesave synojnë të provojnë ekzistencën reale dhe qëndrueshmërinë e këtij kapaciteti njerëzor dhe jo një disponim formal vetëm në momentin e ofertimit.

Kërkesa për disponimin e stafit inxhinierik të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit është vendosur në raport të drejtpërdrejtë me natyrën, objektin, volumin, kompleksitetin teknik dhe afatin 24-mujor të realizimit të kontratës. Objekti “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të njësive administrative Golem dhe Synej – Bashkia Kavajë” përbëhet nga disa komponentë teknikë të dallueshëm dhe të ndërvarur, të cilët kërkojnë ekspertizë të specializuar në ndërtim, hidroteknikë, mekanikë, elektrikë, automatizim, elektronikë, gjeodezi/gjeomatikë, gjeologji dhe gjeoteknikë.

Gjithashtu, afati 24 muaj nënkupton një proces ndërtimor afatgjatë, me fronte pune që mund të zhvillohen paralelisht në zona të ndryshme. Vetë preventivi parashikon linjën e dërgimit Çermë, linjën e furnizimit Maskuri, depon 6,000 m³, linjën kryesore të shpërndarjes, linjën kryesore unazore dhe linja shpërndarjeje të ndara në një numër të madh zonash. Për rrjedhojë, numri dhe profilet e kërkuara nuk lidhen thjesht me kohëzgjatjen e kontratës, por me nevojën për drejtim, kontroll dhe mbulim profesional të disa disiplinave dhe fronteve të punës gjatë zbatimit.

1. Dy Inxhinierë Ndërtimi – drejtues teknikë. Kërkesa për 2 inxhinierë ndërtimi kerkohet nga volumi i konsiderueshëm i punimeve civile dhe strukturore dhe nga mundësia e zhvillimit paralel të punimeve të rezervuarit/depos dhe të rrjeteve të ujësjellësit. Preventivi përfshin punime betoni e betonarmeje, hekur betoni, themele, puseta, struktura monolite, shtresa, asfaltim, prishje dhe rikthim të infrastrukturës rrugore. Për linjën e dërgimit, për shembull, janë parashikuar struktura monolite C16/20 dhe C20/25, hekur betoni dhe mbushje me gur kave.

Komponenti më i rëndësishëm strukturor është depoja 6,000 m³. Vetëm për të janë parashikuar 1,052 m³ beton C30/37 për pllakën e rezervuarit, ndërsa më tej preventivi përmban 582 m³ beton për muret 40 cm, 419 m³ për muret 50 cm, 345 m³ për soletën, 86 m³ për trarët dhe 83 m³ për kolonat. Këto janë struktura hidroteknike prej betonarmeje ku kontrolli i armimit, kallëpeve, betonimit, hidroizolimit, tolerancave dhe cilësisë së ekzekutimit është thelbësor.

Për këtë arsye, 2 inxhinierë ndërtimi janë të nevojshëm për ndarjen dhe mbulimin e fronteve të punës, veçanërisht duke konsideruar shtrirjen e objektit dhe afatin 24mujor.

2. Dy Inxhinierë Elektrikë – drejtues teknikë. Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me instalimet elektrike dhe sistemet e komandimit të parashikuara në preventiv. Për depon janë parashikuar ndriçues, përcjellës elektrikë, priza, elektroda tokëzimi, përcjellës tokëzimi dhe instalime të tjera elektrike. Për më tepër, preventivi përmban panel komandimi për ndriçimin, kabllo elektrike, kuadër komandimi me fotoelement, kabllo TU/XLPE, sisteme tokëzimi dhe rrufepritëse.

Komponenti SCADA përmban gjithashtu kuadro elektrikë të pusetave, ndërsa në sistem janë parashikuar panele diellore, bateri/kontroller, kabllo bakri dhe kuadro elektrikë në një numër të konsiderueshëm pikash.

Kërkesa për 2 inxhinierë elektrikë lidhet kështu me nevojën për mbulimin e instalimeve elektrike të objekteve dhe, paralelisht, të instalimeve të shpërndara në pusetat, pajisjet e monitorimit dhe sistemin SCADA. Afati 24-mujor dhe shtrirja e sistemit krijojnë nevojë për kontroll të vazhdueshëm të këtyre punimeve.

3. Një Inxhinier Mekanik – drejtues teknik. Profili mekanik është i domosdoshëm për montimin, kontrollin dhe vënien në funksion të pajisjeve hidromekanike të rrjetit. Preventivi përmban tuba dhe rakorderi me dimensione dhe presione të ndryshme, saraçineska, xhunto çmontimi, pjesë speciale, matësa uji, pajisje kontrolli niveli etj. Për depon, ndër të tjera, janë parashikuar saraçineska DN 300, DN 350 dhe DN 500, si dhe matës uji induktiv dhe matës niveli ultrasonik. Veçanërisht domethënës është sistemi i klorinimit, i cili përfshin 4+1 pompa klori, rezervuarë klori, tubacione PVC dhe aksesoret përkatës. Këto janë punime dhe pajisje me karakter të qartë mekanik/hidromekanik, ndaj kërkesa për inxhinier mekanik është e lidhur drejtpërdrejt me preventivin.

4. Dy Inxhinierë Hidroteknikë – drejtues teknikë. Ky është një nga profilet kryesore të kontratës, pasi vetë objekti është rikonstrukcion dhe ndërtim i një sistemi ujësjellësi. Preventivi përmbledhës përmban linjë dërgimi, linjë furnizimi, depo 6,000 m³, linjë kryesore shpërndarjeje, linjë unazore dhe një numër shumë të madh linjash shpërndarjeje sipas zonave.

Inxhinieri hidroteknik duhet të ndjekë vendosjen e tubacioneve, nyjet hidraulike, pusetat, valvulat, saraçineskat, matësit, presionet, rakorderitë, provat hidraulike, lidhjet dhe funksionimin e përgjithshëm të rrjetit. Vetëm në linjën kryesore të shpërndarjes janë parashikuar matësa uji induktivë DN125 dhe DN150 dhe pajisje ajrimi të rrjetit.

Kërkesa për 2 hidroteknikë si drejtues teknikë lidhet me shtrirjen e rrjetit dhe ekzistencën e disa fronteve të punës: njëri mund të mbulojë në mënyrë të vazhdueshme linjat kryesore/depon dhe veprat hidroteknike, ndërsa tjetri rrjetet e shpërndarjes dhe nyjet përkatëse.

5. Një Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik – drejtues teknik. Natyra lineare dhe shtrirja territoriale e objektit e bëjnë të domosdoshëm kontrollin gjeodezik gjatë zbatimit. Ndërtimi i linjave kryesore, unazore dhe i dhjetëra segmenteve të shpërndarjes kërkon piketimin e traseve, përcaktimin e kuotave, pozicionimin e pusetave dhe nyjeve, kontrollin e thellësive dhe pjerrësive, si dhe evidentimin e gjendjes faktike të punimeve të realizuara.

Ky profil është në funksionin teknik horizontal i domosdoshëm për realizimin korrekt të zërave linearë të preventivit. Shtrirja e punimeve në shumë zona të veçanta të rrjetit është e evidentuar qartë në preventivin përmbledhës.

6. Një Inxhinier Automatizimi, i certifikuar për Software programimi PLC dhe SCADA – drejtues teknik. Ky profil ka një lidhje veçanërisht të drejtpërdrejtë me preventivin. Preventivi përmban një kapitull të posaçëm “Ndërtimi i sistemit SCADA”, me vlerë 27,277,161.26 lekë pa TVSH.

Në zërat konkretë parashikohen: modem komunikimi i postit qendror me pajisjet në objekte; program SCADA; dhënës niveli piezometrik 4–20 mA; pajisje RTU për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave; si dhe programimi i pajisjeve elektronike.

Prandaj, kërkesa për inxhinier automatizimi me njohuri/certifikim në programim PLC dhe SCADA është e lidhur drejtpërdrejt me punimet që duhet të realizohen. Ky specialist duhet të garantojë integrimin e sensorëve, RTU-ve, komunikimit dhe software-it të mbikëqyrjes e komandimit në një sistem funksional.

7. Një Inxhinier Gjeolog – drejtues teknik. Kërkesa lidhet me karakteristikat e punimeve nëntokësore dhe të gërmimeve përgjatë traseve dhe në veprat strukturore. Preventivi parashikon gërmime në shkëmb të copëtuar, në tokë të zakonshme, në tokë të fortë, gërmime kanalesh, mbushje, rrafshim dhe ngjeshje. Në një prej segmenteve janë parashikuar 61 m³ gërmim shkëmbi, 303 m³ gërmim në tokë të zakonshme, 590 m³ në tokë të fortë dhe 2,356.20 m³ gërmim mekanik në kanale. Në segmente të tjera sasitë janë edhe më të mëdha, përfshirë 1,112 m³ gërmim në tokë të fortë dhe 4,368.30 m³ gërmim mekanik.

Prania e materialeve të ndryshme gjeologjike përgjatë një rrjeti të shtrirë e justifikon specialistin për vlerësimin e kushteve reale të terrenit gjatë gërmimeve dhe evidentimin e problematikave që mund të ndikojnë në stabilitetin e kanaleve, themeleve dhe veprave.

Stafi tjetër inxhinierik

Një Inxhinier Elektronik. Kërkesa është e lidhur me komponentin elektronik të sistemit SCADA dhe të monitorimit. Preventivi parashikon RTU, modem komunikimi, dhënës niveli piezometrik 4–20 mA, programim pajisjesh elektronike, router, kompjuter dhe pajisje të tjera komunikimi. Gjithashtu, në depon 6,000 m³ është parashikuar një RTU e përshtatshme për komunikim me programin ekzistues SCADA dhe sistem monitorimi me kamera.

Ky profil plotëson inxhinierin e automatizimit: automatizimi mbulon logjikën e kontrollit, programimin dhe integrimin SCADA, ndërsa elektroniku mbulon pajisjet elektronike, sinjalet, komunikimin dhe ndërfaqet ndërmjet sensorëve, RTU-ve dhe sistemit qendror.

Një Inxhinier Ndërtimi, profili Gjeoteknik. Ky profil lidhet drejtpërdrejt me punimet e gërmimit, themeleve, mbushjeve dhe ngjeshjeve. Preventivi përmban gërmime në tokë të butë, të zakonshme dhe të fortë, gërmime në shkëmb, mbushje dhe ngjeshje, shtresa çakëlli e stabilizanti. Vetëm në një zonë shpërndarjeje janë parashikuar gërmime në tokë të butë, të zakonshme dhe të fortë, si dhe 1,288 m³ gërmim mekanik në kanale.

Inxhinieri gjeoteknik është i nevojshëm për vlerësimin teknik të sjelljes së terrenit, stabilitetit të gërmimeve, përshtatshmërisë së materialeve të mbushjes, ngjeshjes dhe kushteve të bazamentit, veçanërisht për depon 6,000 m³ dhe veprat e tjera prej betonarmeje. Funkcioni i tij është i ndryshëm nga ai i gjeologut: gjeologu identifikon dhe vlerëson karakteristikat gjeologjike të terrenit, ndërsa gjeotekniku i trajton ato në raport me projektimin dhe sjelljen e veprës ndërtimore.

Një Inxhinier Hidroteknik – staf tjetër. Kërkesa për një hidroteknik shtesë, krahas dy drejtuesve teknikë, mbështetet te përmasat e rrjetit dhe numri i madh i fronteve të punës. Preventivi përmban linja dërgimi/furnizimi, linja kryesore, unazë dhe një numër të madh rrjetesh shpërndarëse.

Specialisti shtesë angazhohet në kontrollin operacional të montimit të tubacioneve, rakorderive, pusetave dhe nyjeve, kryerjen e provave dhe verifikimin e parametrave teknikë, ndërsa drejtuesit teknikë mbajnë përgjegjësinë e përgjithshme teknike.

Një Inxhinier Gjeomatik – staf tjetër. Edhe ky specialist duhet diferencuar nga drejtuesi teknik gjeodet/topograf/gjeomatik. Për një rrjet kaq të shtrirë, gjatë 24 muajve nevojitet jo vetëm piketimi dhe kontrolli topografik në terren, por edhe përpunimi dhe administrimi i informacionit hapësinor të rrjetit të realizuar: koordinatat e tubacioneve, pusetave, valvulave, nyjeve dhe pajisjeve, si dhe dokumentimi i gjendjes as-built.

Kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë sepse sistemi përfundimtar nuk është vetëm fizik, por përmban edhe monitorim elektronik/SCADA të pikave të rrjetit. Preventivi parashikon RTU, transmetim të të dhënave dhe program SCADA. Për rrjedhojë, administrimi i saktë i pozicionit dhe identifikimit të aseteve të rrjetit është funksionalisht i lidhur me menaxhimin e tij.

Kërkesa është vendosur në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilit drejtuesit teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës për realizimin e veprës sipas projektit, kushteve dhe specifikimeve teknike, ndërsa drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për veprat me vlerë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, Udhëzimi parashikon përgjegjës teknik të kantierit rezident, me kohë të plotë në objekt dhe të diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Në rastin konkret, kërkesa është e domosdoshme dhe proporcionale edhe për shkak të natyrës, vlerës dhe kompleksitetit të objektit, i cili përfshin ndërtimin/rikonstruksionin e linjave të dërgimit, furnizimit, linjave kryesore dhe unazore të ujësjellësit, rrjeteve të shpërndarjes në një numër të madh zonash, ndërtimin e depos së re me kapacitet 6,000 m³, si dhe punime gjurmimi, betonarmeje, hidromekanike, elektrike dhe automatizimi/SCADA.

Duke marrë në konsideratë gjithashtu **afatin 24-mujor të zbatimit**, shtrirjen territoriale të objektit dhe zhvillimin e disa fronteve të punës, është e nevojshme që operatori ekonomik të identifikojë që në fazën e ofertimit personin përgjegjës për drejtimin teknik të punimeve dhe të garantojë angazhimin e tij gjatë realizimit të kontratës. Për këtë arsye kërkohet që Drejtuesi Teknik të jetë pjesë e licencës profesionale të shoqërisë dhe të deklarohet angazhimi i tij në objekt, ndërsa dokumentacioni provues – kontrata e punës e vlefshme gjatë periudhës së zbatimit, diploma, librezë e punës dhe CV-ja – shërben për verifikimin e marrëdhënies së punës, kualifikimit dhe eksperiencës profesionale të personit të deklaruar.

Kërkesa për disponimin e stafit teknik të specializuar është përcaktuar në përputhje me natyrën, përmasat, kompleksitetin teknik, shtrirjen territoriale dhe volumet e punimeve të objektit “Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Synej dhe Golem, Bashkia Kavajë”.

Objekti nuk konsiston vetëm në vendosjen e një linje të vetme ujësjellësi, por përfshin linjën e dërgimit, linjën e furnizimit, linjën kryesore të shpërndarjes, unazën, rrjetet shpërndarëse në një numër të madh zonash, si dhe ndërtimin e depos së re me kapacitet 6,000 m³. Për pasojë, gjatë realizimit të kontratës do të kryhen paralelisht ose në mënyrë të mbivendosur punime gjurmimi, shtrimi tubacionesh, montimi rakorderish dhe pajisjesh hidraulike, betonarmeje, armimi, kallëpesh, hidroizolimi, punime elektrike, rikthim shtresash rrugore etj.

Teknik Ndërtimi – 4 punonjës

Kërkesa për 4 teknikë ndërtimi lidhet drejtpërdrejt me numrin e nënobjekteve dhe fronteve të punës. Punimet zhvillohen si në depon e re 6,000 m³, ashtu edhe përgjatë linjave kryesore dhe rrjeteve shpërndarëse të zonave të ndryshme.

Vetëm për depon 6,000 m³ preventivi parashikon 582 m³ beton C30/37 për muret 40 cm, 419 m³ për muret 50 cm, 345 m³ për soletën, 86 m³ për trarët, 83 m³ për kolonat dhe 75 m³ për krijimin e pjerrësive, pra rreth 1,590 m³ beton C30/37 vetëm në këta zëra.

Ndërkohë, linjat kanë punime të veçanta ndërtimore. Linja kryesore Agonas–Unaza Qerret përmban 18 m³ beton C16/20, 59.6 m³ beton C20/25, 8.94 ton hekur dhe 3,292 m³ mbushje me gur kave.

4 teknikët e ndërtimit lidhen me nevojën për ndjekjen teknike të disa fronteve të punës, kontrollin e gjurmimeve, betonimeve, armimeve, mbushjeve, shtresave dhe rikthimit të territorit.

Teknik Topograf – 1 punonjës

Kërkesa për 1 teknik topograf është e domosdoshme për natyrën lineare të objektit. Ndërtimi i linjave të ujësjellësit kërkon piketimin e aksit, kontrollin e kuotave dhe thellësive të kanaleve, pozicionimin e pusetave, nyjeve dhe rakorderive, kontrollin gjatë shtrimit të tubacioneve dhe evidentimin përfundimtar të gjendjes së zbatuar.

Vetëm në një zonë shpërndarëse, Zona 18, preventivi parashikon 1,432.60 m³ gjërmim mekanik kanali, krahas gjurmimeve manuale në tokë të butë, të zakonshme dhe të fortë. Këto punime përsëriten në shumë zona të rrjetit, çka e bën funksionin topografik të vazhdueshëm gjatë zbatimit.

Teknik Hidroteknik – 1 punonjës dhe Hidraulikë – 7 punonjës

Këto profile lidhen me thelbin e kontratës, që është ndërtimi dhe rikonstruksioni i sistemit të furnizimit me ujë.

Preventivi parashikon vendosjen dhe montimin e tubacioneve dhe të një numri të madh pajisjesh hidraulike: saraçineska, rakorderi, manikota, bërryla, filtra, matësa induktivë të ujit, ajrues etj. Në linjën e dërgimit evidentohen, ndër të tjera, saraçineska DN100, saraçineska flutur DN350, manikota DN600 PN25, bërryla DN350, filtër DN350, matës induktiv DN350 dhe ajrues DN100. Në linjën kryesore parashikohen gjithashtu matës induktivë DN125 dhe DN150, ajrues dhe tubacione/rakorderi me fllanxha.

Për këtë arsye 1 teknik hidroteknik kërkohet për organizimin dhe kontrollin teknik të këtyre proceseve, ndërsa 7 hidraulikët janë të nevojshëm për kryerjen fizike të montimit të tubacioneve, rakorderive, saraçineskave, pajisjeve matëse dhe elementeve të nyjeve hidraulike. Shtate hidraulike janë vendosur në raport me shtrirjen e rrjetit dhe zhvillimin e punimeve në disa zona, jo si një skuadër e përqendruar vetëm në një pikë.

Karpentierë – 5; Hekurkthyes – 5; Betonues – 6

Këto tre kategori lidhen drejtpërdrejt me ndërtimin e depos së re 6,000 m³ dhe strukturat e tjera prej betonarmeje.

Preventivi evidenton vetëm për elementet kryesore të rezervuarit rreth 1,590 m³ beton C30/37, të shpërndarë në mure, soletë, trarë, kolona dhe krijimin e pjerrësive. Krahas tyre ka punime betonarmeje edhe përgjatë linjave dhe rrjetit shpërndarës; p.sh., linja kryesore ka beton C16/20 dhe C20/25 dhe 8.94 ton hekur betoni.

Për këtë arsye kërkohen 5 karpentierë për realizimin dhe çmontimin e kallëpeve të mureve, soletave, trarëve, kolonave dhe elementeve të tjera; 5 hekurkthyes për përgatitjen, prerjen, kthimin

dhe montimin e armaturës; si dhe 6 betonues për proceset e betonimit, shpërndarjes, vibrimit, nivelimit dhe përfundimit të betonit.

Kerkesat janë të lidhur me faktin se betonimi i një rezervuari të këtij kapaciteti kërkon skuadra funksionale pune, dhe jo një specialist të vetëm për secilin proces.

Saldatorë – 2 dhe Montatorë – 2

Kërkesa për 2 saldatorë dhe 2 montatorë lidhet me montimin e elementeve metalike dhe hidromekanike të objektit, tubacioneve, rakorderive, fllanxhave, elementeve mbështetëse dhe pajisjeve.

Preventivi përmban edhe tuba çeliku Ø rreth 200 mm, ndërsa në linjat dhe depon parashikohen tubacione dhe elemente të shumta metalike e prej gize. Në depon e re parashikohen, ndër të tjera, tuba gize me fllanxha DN500 PN16.

Dy punonjës për secilin profil mundësojnë formimin e një ekipi funksional për montimin dhe bashkimin e elementeve, si dhe zhvillimin e punimeve pa ndërprerje për shkak të varësisë nga një punonjës i vetëm.

Hidroizolues – 4 punonjës

Kërkesa për 4 hidroizolues është veçanërisht e lidhur me ndërtimin e rezervuarit të ujit 6,000 m³. Ky është një objekt që duhet të garantojë papërshkueshmërinë dhe mbrojtjen e strukturës në kontakt të vazhdueshëm me ujin.

Edhe në linjat e ujësjellësit preventivi parashikon elemente specifike hidroizoluese, si Waterstop hydro-expançe 20×20 mm, p.sh. 19.30 ml në linjën e dërgimit dhe 30.90 ml në linjën kryesore.

Për rrjedhojë, 4 hidroizolues lidhen me sipërfaqet dhe elementet e rezervuarit dhe me nevojën që këto procese të kryhen nga personel i specializuar.

Elektricitë – 3 punonjës

Kërkesa për 3 elektricitë lidhet me instalimet elektrike të depos, kabllot e fuqisë dhe kontrollit, panelet, tokëzimet dhe pajisjet elektrike të sistemit të monitorimit dhe automatizimit.

Preventivi i depos përmban, ndër të tjera, kabllo kontrolli Cu të armuar 4×2.5 mm², ndërsa objekti përmban gjithashtu instalime dhe pajisje elektrike të lidhura me funksionimin dhe monitorimin e sistemit.

Duke qenë se instalimet elektrike shtrihen si në depon e re ashtu edhe në pajisjet e vendosura në terren, 3 elektricitë mundësojnë organizimin e një grupi pune për instalim, lidhje, kontroll dhe testim.

Muratorë – 5 dhe Punëtorë të thjeshtë – 10

Kërkesa për 5 muratorë lidhet me punimet ndërtimore ndihmëse, pusetat, sistemimet, riparimet dhe rikthimin e elementeve ndërtimore të prekura nga hapja e kanaleve.

Ndërsa 10 punëtorët e thjeshtë lidhen drejtpërdrejt nga volumet shumë të mëdha të punimeve manuale. Preventivi nuk parashikon vetëm gërmime mekanike. Për linjën e dërgimit janë parashikuar 303 m³ gërmime manuale në tokë të zakonshme dhe 590 m³ në tokë të fortë, krahas 2,356.20 m³ gërmim mekanik.

Edhe në Zona 18 kemi 47.60 m³ gërmim manual në tokë të butë, 159.60 m³ në tokë të zakonshme dhe 50 m³ në tokë të fortë, krahas 1,432.60 m³ gërmim mekanik.

Në Zonën 1 parashikohen përsëri 103.60 m³ gërmim manual në tokë të butë, 143.60 m³ në tokë të zakonshme dhe 125 m³ në tokë të fortë, përveç 1,288 m³ gërmim mekanik.

Këto volume tregojnë qartë nevojën për një grup punëtorësh të thjeshtë për gjurmime manuale, sisteme, ngarkim/shkarkim, asistencë në shtrimin e tubacioneve, mbushje, pastrim dhe punë ndihmëse në disa fronte.

2 shoferë me kategori C dhe CAP

Kërkesa për 2 shoferë lidhet me transportin e materialeve, agregateve, elementeve të tubacioneve dhe produkteve të ndërtimit ndërmjet pikave të furnizimit dhe fronteve të ndryshme të kantierit.

Vetëm linja kryesore përmban 3,292 m³ mbushje me gur kave, ndërsa linja e dërgimit përmban 1,794 m³ të tjera. Në depon e re ka gjithashtu 200 m³ mbushje me çakëll/gur gurore dhe 1,300 m² shtresë zhavorri.

Preventivi parashikon shprehimisht edhe transportin e betonit me autobetonierë, si 42.30 m³ në një nga linjat dhe 67.60 m³ në linjën kryesore.

Për këtë arsye disponimi i dy drejtuesve të mjeteve me kategorinë përkatëse dhe CAP lidhet me nevojat reale të transportit gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesa për 3 Eskavatoristë, 3 Automakinistë dhe 2 Buldozeristë

Keto kërkesa lidhen drejtpërdrejt me makineritë që keni kërkuar në DST. Për realizim ,e suksese te kontrates janë kërkuar eskavatorë, automjete dhe buldozerë, numri i operatorëve korrespondonë me numrin e mjeteve që parashikohet të punojnë njëkohësisht.

3 Eskavatoristë

Kërkesa për 3 eskavatoristë është e kërkuar bazuar nga volumi i konsiderueshëm i gjurmimeve mekanike dhe nga shpërndarja e tyre në nënobjekte të ndryshme.

Preventivi për linjën e dërgimit parashikon 61 m³ gjurmim shkëmbi me ekskavator dhe 2,356.20 m³ gjurmim mekanik kanali në tokë të kategorisë III. Vetëm Zona 18 ka 1,432.60 m³ gjurmim mekanik, ndërsa Zona 1 ka 1,288 m³.

Këto janë vetëm disa nga nënobjektet e preventivit dhe jo totali i gjithë kontratës. Duke qenë se rrjeti ndahet në linja dhe zona të shumta, 3 eskavatoristët mundësojnë operimin e tre makinerive në fronte të ndryshme pune, duke shmangur varësinë e të gjithë grafikut të punimeve nga një makineri dhe një operator i vetëm.

3 Automakinistë

Kërkesa për 3 automakinistë lidhet me përdorimin e mjeteve të rënda të transportit dhe mjeteve teknologjike të kantierit, në funksion të largimit të materialit të gjërmuar dhe furnizimit të fronteve me materiale.

Një element shumë i rëndësishëm është se zëri i preventivit për gjurmimin mekanik përcakton shprehimisht gjurmimin “me shkarkim në mjet”. Për linjën e dërgimit kemi 2,356.20 m³ gjurmim me ekskavator në kanale dhe shkarkim në mjet.

Në të njëjtën kohë duhen transportuar sasi të konsiderueshme materiale mbushëse: 1,794 m³ gur kave në linjën e dërgimit dhe 3,292 m³ në linjën kryesore.

Për rrjedhojë, kërkesa për tre operatorë lidhet me funksionimin e mjeteve të transportit/makinerive përkatëse në mbështetje të fronteve të gjërmimit dhe furnizimit.

2 Buldozeristë

Kërkesa për 2 buldozeristë lidhet me punimet e sistemit të terrenit, shpërndarjes së materialeve, mbushjeve dhe formimit të shtresave.

Preventivi përmban zëra të konsiderueshëm mbushjeje dhe ngjeshjeje. Vetëm linja kryesore përmban 3,292 m³ mbushje me gur kave, ndërsa linja e dërgimit 1,794 m³.

Në depon 6,000 m³ parashikohen 200 m³ mbushje me çakëll dhe gur gurore, e përhapur dhe ngjeshur me makineri, 1,300 m² shtresë zhavorri dhe 1,000 m² stabilizant.

Për linjën e dërgimit parashikohen gjithashtu 140.50 m³ mbushje me çakëll/gur gurore e përhapur dhe ngjeshur me makineri, 1,177.60 m² stabilizant 10 cm dhe 972 m² stabilizant 20 cm.

Këto volume, të shpërndara në zona të ndryshme të objektit, mbështesin nevojën për përdorimin e makinerive të sistemit në më shumë se një front pune dhe, për rrjedhojë, të operatorëve të kualifikuar përkatës.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.
- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.742, datë 06.11.2003). Kërkesa për disponimin e 2 (dy) personave të trajnuar dhe të ngarkuar me përgjegjësi për sigurinë dhe shëndetin në punë është përcaktuar në raport të drejtpërdrejtë me natyrën, volumin, shtrirjen territoriale dhe nivelin e rrezikut të punimeve të objektit. Objekti nuk përbën një kantier të vetëm të përqendruar, por përfshin njëkohësisht punime në linja dërgimi dhe shpërndarjeje, rrjete në zona të ndryshme, ndërtimin e depos së re 6 000 m³, rikthimin e infrastrukturës rrugore, instalime hidraulike dhe elektrike dhe sistem SCADA/RTU.

Preventivi evidenton volume të konsiderueshme gërmimesh mekanike dhe manuale në kanale, transport dheu dhe materialesh, punë me makineri të rënda dhe montim tubacionesh. Vetëm në një segment parashikohen 113 m³ gërmim shkëmbi, 563 m³ gërmim në tokë të zakonshme, 1 112 m³ gërmim në tokë të fortë dhe 4 368.30 m³ gërmim mekanik në kanale.

Paralelisht, ndërtimi i depos 6 000 m³ përbën një front të veçantë pune, ku preventivi parashikon 335 ton hekur betoni, 1 200 m² skela metalike deri në 10 m dhe volume të konsiderueshme betoni C30/37 për muret, soletën, trarët dhe kolonat e rezervuarit.

Për shkak të mundësisë dhe nevojës për zhvillimin paralel të punimeve lineare në rrjet dhe të punimeve në depon 6 000 m³, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se një person i vetëm përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk do të siguronte mbulimin efektiv të të gjitha fronteve. Për këtë arsye janë kërkuar minimalisht 2 persona, ku në aspektin organizativ njëri mund të mbulojë punimet lineare të rrjetit – gërmime, transport, montim tubacionesh dhe rikthim rrugor – ndërsa tjetri punimet e depos dhe instalimeve, përfshirë punimet betonarme, punimet në lartësi, skelat, instalimet elektrike dhe teknologjike.

Kërkesa lidhet me qëllimin dhe detyrimet e ligjit nr. 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar, për garantimin e sigurisë së punëmarrësve nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve të rrezikut, informimit dhe formimit të punëmarrësve.

Kërkesa për 1 (një) Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin është përcaktuar duke marrë në konsideratë kompleksitetin e kantierit dhe praninë në preventiv të instalimeve elektrike, kuadrove të komandimit, kablllove, sistemit të tokëzimit dhe rrufepritjes, pajisjeve SCADA/RTU, elementeve metalike dhe sistemit teknologjik të klorinimit. Preventivi

përmban shprehimisht linja kabllore, kuadro elektrikë, përçues mbrojtës, sistem tokëzimi dhe rrufepritës, të cilat kërkojnë masa të posaçme të mbrojtjes dhe reagimit ndaj zjarrit.

Gjithashtu, preventivi parashikon sistem klorinimi me 4+1 pompa dhe rezervuarë klori 3×80 litra, si dhe dush emergjence, duke evidentuar ekzistencën e instalimeve teknologjike që kërkojnë organizim të masave të emergjencës dhe shpëtimit.

Në funksion të proporcionalitetit të kërkesës, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar që Eksperti Zjarrfikës mund të disponohet edhe nëpërmjet kontratës së punës/shërbimit vetëm për realizimin e objektit dhe deri në përfundimin e kontratës, pa kërkuar domosdoshmërisht që ky specialist të jetë pjesë e përhershme e organikës së operatorit ekonomik.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me Licencë Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve të ngurta inerte”, së bashku me aktin e miratimit dhe kodet përkatëse të mbetjeve, lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit dhe me zërat e preventivit që gjenerojnë sasi të konsiderueshme dheu të gërmuar, materiale nga prishjet, beton, asfalt dhe materiale të tjera inerte, të cilat duhet të largohen nga frontet e punës dhe të transportohen në mënyrë të kontrolluar.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licencë të vlefshme Kodi III.2.B për aktivitetin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve është përcaktuar në raport të drejtpërdrejtë me natyrën dhe volumen e punimeve të parashikuara në preventiv. Objekti përfshin hapjen e kanaleve për rrjetin e ujësjellësit, gërmime mekanike dhe manuale, prishje të shtresave të betonit dhe asfaltit, si dhe largimin e materialeve të dala nga këto procese.

Preventivi evidenton volume të konsiderueshme gërmimesh, ku vetëm në një segment parashikohen 113 m³ gërmim shkëmbi, 563 m³ gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, 1,112 m³ gërmim në tokë të fortë dhe 4,368.30 m³ gërmim mekanik, ndërsa në segmente të tjera parashikohen volume të tjera të konsiderueshme të të njëjtës natyrë.

Për largimin e materialeve të gjeneruara, preventivi përmban shprehimisht zëra transporti të materialeve dhe dherave, ku vetëm në pjesë të veçanta të objektit parashikohen 5,888.30 m³, 8,703.70 m³ dhe 9,861 m³ transport.

Gjithashtu, preventivi përmban zëra të prishjes së shtresave të betonit, mureve dhe ndërhyrjeve në asfalt, të cilat gjenerojnë materiale inerte nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes. Për pasojë, një pjesë e materialit të nxjerrë që nuk ripërdoret në objekt duhet të largohet dhe të menaxhohet në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Kërkesa lidhet me ligjin nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore për menaxhimin e mbetjeve inerte, sipas të cilave aktivitetet e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve duhet të kryhen nga subjekte që disponojnë autorizimet/licencat përkatëse. Për rrjedhojë, disponimi i licencës Kodi III.2.B është kërkuar për të garantuar që operatori ekonomik ka kapacitetin dhe të drejtën ligjore për largimin dhe transportimin e mbetjeve inerte që gjenerohen gjatë realizimit të kontratës.

Në këto kushte, kriteri vlerësohet i lidhur dhe proporcional me objektin e kontratës, pasi aktiviteti i grumbullimit dhe transportit të materialeve të dala nga gërmimet dhe prishjet është i parashikuar dhe i matshëm në preventiv dhe përbën proces të domosdoshëm për realizimin e rregullt të punimeve, mirëmbajtjen e kantierit dhe mbrojtjen e mjedisit.

2.3.5 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
3	Autovinc me kapacitet mbajtës deri ne 10 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 3.5 Ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
5	Minieskavator me zinxhir gome	2 cope	Në pronësi ose me qera
6	Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Eskavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Eskavator me zinxhir 20ton + Çekic Pneumatik	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Fadrome me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
10	Miningarkues / bobcat	4 cope	Në pronësi ose me qera
11	Autobot uji	2 cope	Në pronësi ose me qera

12	Rrul gome-hekur jo me pak se 10 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
13	Rrul hekur-hekur jo me pak se 8 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
14	Dumper minimumi 5 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
15	Dumper minimumi 2 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
16	Autobetoniere	3 cope	Në pronësi ose me qera
17	Pompe Betoni/ Autopompe Betoni	1 cope	Në pronësi ose me qera
18	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
19	Asfalto-shtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
20	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
21	Fshese asfalti	1 cope	Në pronësi ose me qera
22	Tokmak	2 copë	Në pronësi ose me qera
23	Sharre me disk per asfalt	2 cope	Në pronësi ose me qera
24	Betoniere Kantieri 0.25m3	2 cope	Në pronësi ose me qera
25	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	3 cope	Në pronësi ose me qera
26	Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke	3 cope	Në pronësi ose me qera
27	GPS/Total Station	2 cope	Në pronësi ose me qera
28	Nivelues topografik me lazer	1 cope	Në pronësi ose me qera
29	Tokmak Elektrik	2 cope	Në pronësi ose me qera
30	Gjenerator Motogjenerator	4 cope	Në pronësi ose me qera
31	Vibrator Betoni	4 cope	Në pronësi ose me qera
32	Aparat per kryerjen e testeve te presionit te linjave te ujesjellesit	1 cope	Në pronësi ose me qera
33	Elektrosaldatrice/motosaldatrice	2 cope	Në pronësi ose me qera

34	Fabrike betoni e pajisur me leje mjedisore, QKL III.1.B	1 cope	Në pronësi ose me qera, ose me kontrate furnizimi
35	Pompe uji	3 cope	Në pronësi ose me qera
36	Armature	1000m2	Në pronësi ose me qera
37	Matrapik	1 cope	Në pronësi ose me qera
38	Testues instalimesh multifunksional	1 cope	Në pronësi ose me qera
39	Matës izolacioni	1 cope	Në pronësi ose me qera
40	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	1 cope	Në pronësi ose me qera
41	Makineri mikrotunelimi horizontal per kalim tubacioni	1 copë	Në pronësi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi 70 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

- ❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me *plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8*. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); te vlefshme.

Për mjetet e siguruara me qera, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë rregjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit të vlefshme. Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimit të mjetit.

Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Shënim: Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore **e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 24 muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar në SPE

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier** për punimet në objekt.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentim: Kërkesa që Operatori Ekonomik të paraqesë Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier lidhet drejtpërdrejt me kompleksitetin e objektit dhe me faktin se punimet nuk zhvillohen në një kantier të vetëm të përqendruar, por në një numër të madh nënobjektesh dhe zonash të ndryshme territoriale.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier është përcaktuar në përputhje me natyrën, volumin, kompleksitetin teknik dhe shtrirjen territoriale të punimeve objekt kontrate, si dhe me rregullat që disiplinojnë organizimin dhe sigurinë gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit.

Objekti përfshin realizimin e linjave të dërgimit dhe furnizimit, linjës kryesore të shpërndarjes, unazës, rrjeteve shpërndarëse në zona të ndryshme, si dhe ndërtimin e depos së re me kapacitet 6,000 m³. Punimet përfshijnë procese të njëpasnjëshme dhe të ndërvatura, si gërmime manuale dhe mekanike, gërmime në tokë të fortë dhe shkëmb, transport dhe largim materiale, shtrim tubacionesh, montim rakorderish dhe pajisjesh hidraulike, mbushje dhe ngjeshje, betonarme, armim, kallëpe, hidroizolim, instalime elektrike dhe rikthim të shtresave. Vetëm në linjën e dërgimit parashikohen 2,356.20 m³ gërmime mekanike me ekskavator dhe shkarkim në mjet, krahas 303 m³ gërmimeve manuale në tokë të zakonshme dhe 590 m³ në tokë të fortë. Ndërkohë, ndërtimi i rezervuarit 6,000 m³ përmban volume të konsiderueshme betonarmeje në mure, soletë, trarë dhe kolona.

Për shkak të këtyre karakteristikave, Planorganizimi është i nevojshëm për të evidentuar mënyrën e organizimit të kantierit dhe fronteve të punës, rendin teknologjik të proceseve, organizimin e personelit dhe makinerive, lëvizjen e mjeteve, furnizimin dhe depozitimin e materialeve dhe koordinimin ndërmjet proceseve të ndryshme, me qëllim realizimin e punimeve në mënyrë të organizuar dhe në përputhje me kërkesat teknike të zbatimit.

Plani i Sigurisë në Kantier është i domosdoshëm për identifikimin dhe vlerësimin paraprak të risqeve që burojnë nga punimet konkrete dhe për përcaktimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse gjatë zbatimit. Në veçanti, natyra e objektit paraqet risqe që lidhen me kanalet dhe gërmimet e hapura, punën me ekskavatorë, buldozerë dhe mjete transporti, ngarkim-shkarkimin e materialeve, punimet e betonarmesë dhe kallëpeve, punimet elektrike, montimin e pajisjeve hidromekanike, qarkullimin e mjeteve dhe personelit, si dhe mbrojtjen dhe sinjalizimin e zonave të punës.

Kërkesa mbështetet gjithashtu në kuadrin ligjor për sigurinë dhe shëndetin në punë, në veçanti Ligjin nr. 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, për miratimin e Rregullores “Për sigurinë në kantier”, e ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore për përdorimin e pajisjeve të punës, pajisjeve mbrojtëse individuale dhe sinjalistikën në kantier. Për sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e Planorganizimit dhe Planit të Sigurisë në Kantier është drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës dhe risqet konkrete që shoqërojnë realizimin e tij, duke shërbyer për të garantuar që operatori ekonomik ka analizuar paraprakisht organizimin teknik të zbatimit dhe masat e nevojshme për mbrojtjen e punëmarrësve, personave të tretë dhe zhvillimin e sigurt të punimeve.

Në përcaktimin e mjeteve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit “Rikonstruktion i tëujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Synej dhe Golem, Bashkia Kavajë”, Autoriteti Kontraktor është mbështetur në natyrën e punimeve, volumin e zërave të preventivit, shtrirjen territoriale të objektit dhe nevojën për zhvillimin paralel të disa fronteve të

punës. Kërkesat për disponimin e mjeteve janë përcaktuar në funksion të proceseve konkrete të realizimit të kontratës, ku përfshihen punime masive gjërmimi dhe transporti, hapje kanalesh në zona të ndryshme, furnizim dhe montim tubacionesh me diametra të ndryshëm, transport dhe pozicionim të elementeve të rënda prej gize dhe HDPE, si dhe furnizim të vazhdueshëm të fronteve të punës me materiale, pajisje dhe rakorderi.

Kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton – 3 copë-Kërkesa për disponimin e 3 (tre) kamionëve vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton lidhet drejtpërdrejt me volumin e konsiderueshëm të punimeve të transportit të parashikuara në preventiv. Në preventiv ka zëra “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km”, me volume të konsiderueshme. Vetëm në disa prej nënobjekteve evidentohen sasi prej 9,861 m³, 8,703.70 m³, 5,888.30 m³, 5,874 m³ dhe 5,078.38 m³ materialeve dhe dherash për transport. Këto volume janë nga gjërmimet për ndërtimin e depos, linjave kryesore dhe rrjeteve shpërndarëse dhe kërkojnë një kapacitet real transportues, në mënyrë që procesi i gjërmimit të mos ndërpritet për shkak të mungesës së mjeteve për largimin e materialit. Numri prej 3 kamionësh është vlerësuar i nevojshëm edhe nga pikëpamja e organizimit të ciklit të transportit, duke krijuar mundësinë që një mjet të jetë në proces ngarkimi, një mjet në transport dhe një tjetër në shkarkim/kthim, si dhe duke siguruar mbulimin e fronteve të ndryshme të punës. Për rrjedhojë, ky kapacitet është përcaktuar si kapacitet minimal operacional që lidhet drejtpërdrejt me sasinë e transportit të preventivuar.

Kamionë vetëshkarkues me kapacitet 10–20 ton – 3 copë-Kërkesa për 3 (tre) kamionë vetëshkarkues me kapacitet 10–20 ton lidhet me të njëjtat procese transporti, por është përcaktuar duke pasur parasysh se objekti shtrihet në një numër të madh zonash dhe rrugësh me karakteristika të ndryshme aksesit. Preventivi përfshin volume transporti jo vetëm në nënobjektet kryesore, por edhe në zona të veçanta të rrjetit, ku parashikohen respektivisht 1,426.94 m³, 2,115.44 m³, 2,780.06 m³, 1,233.60 m³, 1,500.90 m³, 1,024.96 m³, 1,155.52 m³ dhe 1,255.98 m³ transport materiale/dherash.

Përdorimi i kamionëve me kapacitet 10–20 ton është i përshtatshëm për frontet e punës me akses më të kufizuar, rrugët lokale dhe zonat ku manovrimi i mjeteve me tonazh më të lartë mund të jetë më i vështirë. Kombinimi i mjeteve mbi 20 ton me mjete 10–20 ton i jep operatorit ekonomik fleksibilitetin e nevojshëm për organizimin e transportit në varësi të karakteristikave të çdo fronti pune dhe shmang bllokimin e procesit teknologjik për shkak të kufizimeve të aksesit.

Autovinc me kapacitet mbajtës deri në 10 ton – 2 copë-Kërkesa për 2 (dy) autovinca me kapacitet mbajtës deri në 10 ton lidhet drejtpërdrejt me punimet e furnizimit, shkarkimit, ngritjes dhe pozicionimit të tubacioneve dhe elementeve hidraulike me dimensione dhe peshë të konsiderueshme. Preventivi parashikon sasi të mëdha tubacionesh PE 100 RC me diametra të konsiderueshme. Vetëm në linjën kryesore parashikohen ndër të tjera 1,157 ml tub DN 400 dhe 2,879 ml tub DN 450, ndërsa në linjën unazore parashikohen 2,721 ml tub DN 200, 906 ml DN 315 dhe 2,604 ml DN 400.

Gjithashtu, për depon dhe linjat kryesore preventivi përfshin elemente të shumta prej gize me diametra DN 300, DN 350 dhe veçanërisht DN 500, me gjatësi që arrijnë deri në 4,000 mm, si dhe

xhunto çmontimi dhe elemente të tjera me fllanxha. Për shkak të dimensioneve dhe peshës së këtyre elementeve, operacionet e shkarkimit, ngritjes dhe pozicionimit nuk mund të mbështeten vetëm në fuqi punëtore manuale, por kërkojnë mjete të përshtatshme ngritëse. Kërkesa për 2 autovinca lidhet gjithashtu me faktin se punimet e tubacioneve realizohen në disa fronte, duke bërë të nevojshëm mbulimin paralel të të paktën dy zonave të punës dhe duke shmangur ndërprerjen e montimit për shkak të lëvizjes së të njëjtit mjet nga një front në tjetrin.

Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton – 3 copë-Kërkesa për 3 (tre) kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton lidhet me funksionimin logjistik të kantierit dhe furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të shpërndara me materiale dhe pajisje të përmasave të vogla dhe të mesme.reventivi përmban në mënyrë të përsëritur rakorderi, adaptorë elektrofuzivë, nipla, filtra, saraçineska, matësa uji, pjesë lidhëse, kablo elektrike, pajisje elektrike dhe elektronike dhe pajisje SCADA/RTU. Vetëm në një nga zonat parashikohen adaptorë elektrofuzivë, nipla, filtra dhe saraçineska në sasi të konsiderueshme. Për këto materiale nuk është teknikisht dhe ekonomikisht i arsyeshëm përdorimi i kamionëve të mëdhenj vetëshkarkues. Kamionçinat mundësojnë furnizimin e shpejtë të fronteve me rakorderi, materiale harxhuese, vegla dhe pajisje, si dhe lëvizjen ndërmjet magazinës dhe pikave të ndryshme të punës. Kërkesa për 3 mjete lidhet me shtrirjen e objektit dhe nevojën që furnizimi logjistik të kryhet paralelisht në linjat kryesore, rrjetet shpërndarëse dhe në zonën e depos, pa krijuar ndërprerje të punimeve.

Miniekskavator me zinxhir gome – 2 copë-Kërkesa për disponimin e 2 (dy) miniekskavatorëve me zinxhir gome lidhet me volumin shumë të lartë të gërmimeve në kanale dhe me karakterin linear të rrjetit të ujësjellësit. Preventivi përmban zëra të përsëritur të gërmimit mekanik në kanale. Vetëm në disa nënobjekte evidentohen: 9,766 m³, 7,260.70 m³, 5,338 m³, 4,621.40 m³, 4,368.30 m³, 2,490.40 m³, 2,356.20 m³ dhe volume të tjera gërmimesh mekanike.

Njëkohësisht, rrjeti përfshin një numër shumë të madh linjash shpërndarëse me diametra të vegjël, për shembull PE DN 25, DN 50, DN 63, DN 90 dhe DN 110. Në këto zona, veçanërisht në rrugë lokale, pranë objekteve ekzistuese dhe në hapësira ku manovrimi i makinerive të mëdha është i kufizuar, përdorimi i miniekskavatorëve mundëson kryerjen e kontrolluar të gërmimeve, minimizimin e dëmtimit të sipërfaqeve ekzistuese dhe realizimin e lidhjeve të rrjetit. Kërkesa për 2 miniekskavatorë është lidhur me nevojën për zhvillimin paralel të të paktën dy fronteve të rrjetit shpërndarës.Preventivi emërton në mënyrë të drejtpërdrejtë gërmimin me “ekskavator goma 0.25 m³”; për këtë arsye miniekskavatori me zinxhir gome argumentohet si mjet plotësues për gërmimet në zonat me akses të kufizuar dhe linjat e shpërndarjes, dhe jo si zë i emërtuar fjalë për fjalë në preventiv.Në përcaktimin e mjeteve dhe makinerive të kërkuara për realizimin e objektit, Autoriteti Kontraktor është mbështetur në llojin e proceseve teknologjike, sasitë e punimeve të parashikuara në preventiv, shtrirjen e tyre në disa nënobjekte dhe nevojën për ekzekutimin paralel të punimeve të gërmimit, ngarkim-shkarkimit, mbushjes, sistemimit dhe ngjeshjes së shtresave.

Eskavator me goma – 1 copë-Kërkesa për disponimin e 1 (një) eskavatori me goma lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit: “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet”.

Ky zë gjendet në një numër të madh nënobjektesh me volume të konsiderueshme. Vetëm në disa segmente parashikohen respektivisht 9,766 m³, 7,260.70 m³, 5,338 m³, 4,621.40 m³ dhe 4,368.30 m³ gjermime mekanike. Në nënobjekte të tjera parashikohen gjithashtu 2,490.40 m³, 2,356.20 m³, 1,841 m³ dhe volume të tjera të së njëjtës natyrë. Për rrjedhojë, disponimi i një eskavatori me goma është i lidhur drejtpërdrejt me një zë të emërtuar shprehimisht në preventiv dhe është i nevojshëm për hapjen e kanaleve, ngarkimin e materialit të gërmuar dhe mbështetjen e procesit të montimit të tubacioneve.

Eskavator me zinxhir – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) eskavator me zinxhir lidhet me volumet e larta të gërmimit dhe me nevojën për ndërhyrje në terrene ku kërkohet stabilitet, forcë tërheqëse dhe punë në kushte më të vështira sesa ato të një eskavatori me goma.

Preventivi parashikon jo vetëm gjermime në tokë të zakonshme, por edhe: gjermime në tokë të fortë; gjermime shkëmbore; kanale me gjatësi dhe volume të konsiderueshme; punime për linjat kryesore dhe depon. Në preventiv figuron konkretisht “Gërmim shkëmbi i copëtuar me ekskavator 0.5 m³, shkëmb, në themele gjerësi rreth 2 m, me shkarkim në mjet”, me sasi 61 m³ në një segment dhe 113 m³ në një tjetër. Njëkohësisht, në të njëjtat segmente ka qindra dhe mijëra metra kub gjermime në tokë të fortë dhe të zakonshme. Për këtë arsye, eskavatori me zinxhir shihet si mjet i nevojshëm për punimet e gërmimit në terrene më të vështira, ku stabiliteti i makinerisë dhe kapaciteti i punës janë thelbësorë.

Eskavator me zinxhir 20 ton + çekic pneumatik – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) eskavator me zinxhir 20 ton të pajisur me çekic pneumatik lidhet konkretisht me zërat e gërmimit në tokë të fortë dhe sidomos me zërat e gërmimit shkëmbor. Preventivi parashikon 61 m³ dhe 113 m³ gërmim shkëmbi të copëtuar me ekskavator, ndërsa paralelisht parashikon edhe volume të konsiderueshme gërmimi në tokë të fortë, si p.sh. 590 m³, 1,112 m³, 812 m³ dhe volume të tjera në zona të ndryshme. Përdorimi i çekicit pneumatik është i justifikuar pikërisht për rastet kur materiali i fortë ose shkëmbor nuk mund të gërmohet në mënyrë efektive vetëm me kovën e zakonshme të eskavatorit. Kapaciteti rreth 20 ton siguron stabilitetin dhe fuqinë e nevojshme për përdorimin e çekicit dhe për punë në seksione ku terreni është i fortë ose shkëmbor, çekici pneumatik është pajisje funksionale e nevojshme për zërat e gërmimit shkëmbor/tokës së forte.

Fadromë me goma – 2 copë- Kërkesa për 2 (dy) fadroma me goma lidhet me zërat e preventivit për: mbushjen me çakëll/gur gurore; përhapjen e materialit; ngarkimin dhe sistemimin e materialeve; mbështetjen e proceseve të transportit dhe rehabilitimit të sipërfaqeve. Preventivi parashikon zërin: “Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”, me volume të tilla si: 995.40 m³; 283.70 m³; 200 m³; 183.50 m³; 151.80 m³; 140.50 m³, si dhe shumë volume të tjera në zona të ndryshme. Fadroma është e nevojshme për: grumbullimin dhe ngarkimin e materialit; furnizimin e segmentit me çakëll; shpërndarjen fillestare të materialit; pastrimin dhe sistemimin e frontit të punës.

Miningarkues / Bobcat – 4 copë- Kërkesa për 4 (katër) miningarkues/Bobcat lidhet me karakterin e shpërndarë të punimeve dhe me nevojën për ngarkim, sistemim dhe shpërndarje materiali në hapësira të kufizuara. Objekti përfshin shumë zona të rrjetit të shpërndarjes, me gjermime dhe

rikthime lokale të rrugëve, trotuareve dhe kanaleve. Në shumë prej tyre parashikohen: gërmime mekanike; mbushje; stabilizant; bordura; trotuare; materiale granulare. Në zona të ndryshme parashikohen 1,288 m³, 1,841 m³, 4,621.40 m³, 5,338 m³ gërmime mekanike, të shoqëruara me mbushje, stabilizant dhe rikthime sipërfaqesh.

Miningarkuesi/Bobcat është i përshtatshëm për: pastrimin e materialit pranë kanalit; ngarkime të vogla e të mesme; përhapje çakëlli; sisteme në rrugë të ngushta; punime pranë trotuareve dhe objekteve ekzistuese.

Autobot uji – 2 copë- Kërkesa për 2 (dy) autobote uji lidhet me proceset e: ngjeshjes së shtresave; lagështimit të materialeve granulare; kontrollit të pluhurit gjatë gërmimeve dhe transportit; punimeve të stabilizantit dhe rehabilitimit rrugor. Preventivi përmban zërin “Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”, si dhe volume të mëdha shtresash stabilizanti. Në një nënobjekt parashikohen 5,267.60 m² stabilizant 10 cm, ndërsa në të njëjtin segment ka 995.40 m³ mbushje me çakëll.

Në segmente të tjera parashikohen, ndër të tjera: 1,371.10 m² stabilizant 10 cm dhe 2,627 m² stabilizant 20 cm; 1,989 m² stabilizant 10 cm dhe 1,077 m² stabilizant 20 cm; 622 m² stabilizant 10 cm dhe 3,260 m² stabilizant 20 cm. Për realizimin korrekt të proceseve të ngjeshjes, kontrolli i lagështisë së materialit është pjesë funksionale e procesit teknologjik.

Rrul gome-hekur jo më pak se 10 ton – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) rrul gome-hekur jo më pak se 10 ton lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë shtresa rrugore të realizuara dhe të ngjeshura me makineri. Preventivi përmban: 1,300 m² shtresë zhavor lumi t=10 cm, me cilindrim; 1,000 m² stabilizant t=10 cm; si dhe zëra të shumtë stabilizanti në segmentet e rrjetit. Në linjën unazore parashikohen gjithashtu: 5,267.60 m² stabilizant t=10 cm; 556 m² stabilizant t=20 cm; 4,605 m² binder; 4,605 m² asfaltobeton. Për këto zëra, ngjeshja mekanike është pjesë thelbësore e realizimit të shtresës dhe ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e rrugës së rikthyer.

Rrul hekur-hekur jo më pak se 8 ton – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) rrul hekur-hekur jo më pak se 8 ton lidhet me zërat e shtresave stabilizuese, binderit dhe asfaltobetonit. Preventivi parashikon në një nga nënobjektet kryesore: 5,267.60 m² stabilizant 10 cm; 4,605 m² binder 6 cm; 4,605 m² asfaltobeton 4 cm. Në zona të tjera parashikohen gjithashtu: 1,989 m² binder dhe asfaltobeton; 662 m² binder dhe asfaltobeton; 562 m² binder dhe asfaltobeton. Rruli hekur-hekur është i përshtatshëm për ngjeshjen përfundimtare të shtresave të stabilizantit dhe veçanërisht të shtresave bituminoze.

Dumper minimumi 5 ton – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) dumper me kapacitet minimal 5 ton lidhet me transportin e materialeve brenda kantierit dhe midis pikave ku aksesimi me kamionët e mëdhenj është i kufizuar. Preventivi përfshin një numër të madh zonash ku kryhen: gërmime kanalesh; ngarkim dhe largim materiali; furnizim me çakëll; mbushje dhe sistemim; rehabilitim të rrugëve lokale. Në shumë prej këtyre zonave parashikohen gërmime prej 843 m³, 932.60 m³, 964.20 m³, 975.20 m³, 1,217.20 m³, 1,316.80 m³ etj.

Dumperi shërben për:transport të dherave në distanca të shkurtra brenda frontit; transport të çakëllit dhe materialit mbushës; furnizim të kanaleve; punë në terrene ku kamionët e mëdhenj kanë kufizime manovrimi.Në përcaktimin e makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit, Autoriteti Kontraktor është mbështetur në zërat konkretë të preventivit, volumet e punimeve, teknologjinë e realizimit të tyre dhe organizimin e punimeve në disa fronte të shpërndara.

Preventivi përmban, ndër të tjera, punime masive betoni dhe betonarmeje për depon e re 6,000 m³, punime të shpërndara betoni në rrjet, volume të konsiderueshme mbushjeje dhe stabilizanti, shtresa binderi dhe asfaltobetoni, gjurmime dhe mbushje të kanaleve, si dhe mijëra metra linearë prerje asfalti. Për rrjedhojë, mjetet e kërkuara më poshtë janë vlerësuar si kapacitet teknik i nevojshëm për realizimin normal dhe të vazhdueshëm të këtyre proceseve.

Dumper minimumi 2 ton – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) dumper me kapacitet minimal 2 ton lidhet me transportin e brendshëm të dherave, materialeve granulare dhe materialeve të mbushjes në fronte me akses të kufizuar, ku përdorimi i kamionëve të zakonshëm ose i dumperit me kapacitet më të madh nuk është praktik.

Objekti përmban shumë zona të rrjetit shpërndarës, ku punimet zhvillohen në kanale dhe rrugë lokale. Në preventiv rezultojnë, ndër të tjera, mbushje, rrafshim dhe ngjeshje me tokmak elektrik në sasi prej 408.20 m³, 479 m³ dhe 709.20 m³ vetëm në disa zona, të shoqëruara me gjurmime mekanike përkatësisht 4,621.40 m³, 5,338 m³ dhe 2,490.40 m³. Dumperi 2 ton shërben si mjet plotësues për:transportin në distanca të shkurtra brenda kantierit; largimin lokal të materialit të gjermuar; furnizimin e kanaleve me material mbushës; transportin e çakëllit dhe aggregateve; punën në rrugë të ngushta dhe zona ku mjetet e tonazhit më të lartë kanë kufizime manovrimi.

Autobetoniere – 3 copë- Kërkesa për 3 (tre) autobetoniera mbështetet veçanërisht në volumin shumë të lartë të punimeve betonarme të depos së re 6,000 m³.Vetëm për këtë rezervuar preventivi parashikon:1,052 m³ beton C30/37 për pllakën e rezervuarit; 582 m³ për muret me trashësi 40 cm; 419 m³ për muret me trashësi 50 cm; 345 m³ për soletën; 86 m³ për trarët; 83 m³ për kolonat; 75 m³ për krijimin e pjerrësive. Vetëm këta zëra përfaqësojnë 2,642 m³ beton C30/37, pa përfshirë sasi të tjera të betonit C16/20 dhe C20/25 të parashikuara në nënobjektet e rrjetit.Transportimi i betonit të gatshëm nga impianti deri në pikën e betonimit duhet të kryhet në mënyrë të vazhdueshme, duke ruajtur homogjenitetin dhe punueshmërinë e përzierjes. Për këtë arsye, disponimi i një autobetoniere të vetme do të krijonte ndërprerje të procesit të betonimit.

Numri prej 3 autobetonierash është përcaktuar për të krijuar një cikël të vazhdueshëm furnizimi — ngarkim, transport, shkarkim/betonim dhe kthim — veçanërisht gjatë betonimeve me volum të lartë të pllakave dhe mureve të rezervuarit.Pompë betoni / Autopompë betoni – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) pompë betoni/autopompë betoni lidhet drejtpërdrejt me konfigurimin strukturor dhe sasi të betonit të rezervuarit 6,000 m³.

Preventivi parashikon beton C30/37 për pllakën, muret 40 cm dhe 50 cm, soletën, trarët dhe kolonat e rezervuarit, në një volum të përgjithshëm prej 2,642 m³. Për elemente të tilla strukturore, veçanërisht:mure vertikale; kolona; trarë; soleta; elemente me armaturë të dendur; depozitimi i

kontrolluar dhe i vazhdueshëm i betonit kërkon pajisje pompimi të përshtatshme. Autopompa siguron furnizim të kontrolluar në pika ku autobetoniere nuk mund të kryejë shkarkim të drejtpërdrejtë dhe ndihmon në shmangien e ndërprerjeve të betonimit dhe segregimit të betonit. Për rrjedhojë, kërkesa për 1 pompë/autopompë betoni është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin e strukturës së rezervuarit dhe me vëllimin e lartë të betonit të parashikuar.

Grejder – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) grejder lidhet me punimet e formimit, nivelimit dhe profilimit të shtresave granulare dhe stabilizantit për rikthimin e rrugëve pas vendosjes së tubacioneve. Preventivi parashikon, ndër të tjera: 995.40 m³ mbushje me çakëll dhe gur gurore; 5,267.60 m² stabilizant t=10 cm; 556 m² stabilizant t=20 cm në një segment. Në segmente të tjera parashikohen 1,371.10 m² stabilizant 10 cm dhe 2,627 m² stabilizant 20 cm, si dhe 1,989 m² + 1,077 m² dhe shumë volume të tjera të të njëjtës natyrë. Realizimi i shtresave në kuota dhe pjerrësi të rregullta kërkon përhapjen dhe profilimin e kontrolluar të materialit përpara procesit të ngjeshjes. Grejderi vlerësohet si mjet teknologjik i përshtatshëm për nivelimin, profilimin dhe përgatitjen e shtresave përpara cilindrimin, dhe kërkesa për 1 copë është proporcionale me natyrën e punimeve.

Asfalto-shtruese – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) asfalto-shtruese ka mbështetje të drejtpërdrejtë në preventiv, pasi zërat e binderit dhe asfaltobetonit përcaktohen shprehimisht “me makineri”. Vetëm në një nga segmentet kryesore parashikohen: 4,605 m² shtresë binderi 6 cm me makineri; 4,605 m² shtresë asfaltobeton 4 cm me makineri. Gjithashtu parashikohen: 1,124 m² binder + 1,124 m² asfaltobeton; 1,294 m² + 1,294 m²; 1,989 m² + 1,989 m²; si dhe qindra metra katrorë në secilën nga zonat e tjera të rrjetit. Asfalto-shtruesja është mjeti teknologjik që siguron shpërndarjen uniforme të përzierjes asfaltike, trashësinë e projektuar dhe parapërgatitjen e saj për ngjeshje.

Autobitumatrice – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) autobitumatrice duhet argumentuar si pjesë e procesit teknologjik të realizimit të shtresave bituminoze dhe jo si makineri e emërtuar shprehimisht në preventiv. Preventivi parashikon sipërfaqe të konsiderueshme binderi dhe asfaltobeton, përfshirë 4,605 m² binder + 4,605 m² asfaltobeton, si dhe 1,294 m², 1,124 m², 1,989 m² dhe sipërfaqe të tjera në zona të ndryshme. Në realizimin teknologjik të shtresave bituminoze, autobitumatricja përdoret për shpërndarjen uniforme të materialit lidhës/emulsionit, kur kjo kërkohet nga teknologjia dhe specifikimet e zbatimit, në funksion të aderencës ndërmjet shtresave.

Fshesë asfalti – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) fshesë asfalti lidhet me përgatitjen dhe pastrimin e sipërfaqeve përpara realizimit të shtresave bituminoze. Preventivi parashikon mijëra metra katrorë binder dhe asfaltobeton, përfshirë: 4,605 m² + 4,605 m²; 1,294 m² + 1,294 m²; 1,124 m² + 1,124 m²; 1,989 m² + 1,989 m². Përpara shtrimit të këtyre shtresave, sipërfaqja duhet të jetë e pastruar nga materiale të lirshme, pluhuri dhe mbetje që mund të cenojnë aderencën dhe cilësinë e shtresës së re.

Tokmak – 2 copë- Për këtë pajisje lidhja me preventivin është e drejtpërdrejtë dhe eksplicite. Preventivi përmban në mënyrë të përsëritur zërin: “Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, çdo 30 cm, tokë e zakonshme”. Vetëm në disa zona sasitë janë: 91 m³; 169 m³; 408.20 m³; 479 m³; 709.20 m³; 138.60 m³; Për rrjedhojë, disponimi i tokmakut nuk është thjesht

nevojë e deduktuar nga procesi, por pajisje e përcaktuar nga vetë analiza e preventivit. Kërkesa për 2 copë argumentohet nga shtrirja e rrjetit në shumë zona dhe nga nevoja për kryerjen paralelisht të mbushjes dhe ngjeshjes në të paktën dy fronte pune, pa kushtëzuar një front nga përfundimi i punimeve në tjetrin.

Sharrë me disk për asfalt – 2 copë- Edhe kjo pajisje ka një lidhje shprehimisht të drejtpërdrejtë me preventivin, pasi në një numër shumë të madh nënobjektesh parashikohet zëri: “Prerje asfalti me disk, në të dy anët”. Volumet janë të konsiderueshme. Vetëm disa prej zërave janë: 6,317 ml; 1,794 ml; 1,472 ml; 1,200 ml; 1,150 ml; 992 ml; 936 ml; 873 ml; 827 ml; 740 ml. Preventivi përmban gjithashtu zëra “Prerje rruge betoni, në të dy anët me disk”, p.sh. 542.85 ml, 500 ml, 375 ml, 317 ml etj., sharra me disk është pajisje e domosdoshme për realizimin e drejtpërdrejtë të këtyre zërave.

Betoniere kantieri 0.25 m³ – 2 copë- Kërkesa për 2 (dy) betoniere kantieri 0.25 m³ duhet të ndahet nga autobetoniere/pompa e betonit. Autobetonieret lidhen me betonimet masive të rezervuarit, ndërsa betoniere e kantierit shërben për sasira të vogla dhe të shpërndara betoni, të cilat rezultojnë në shumë zona të rrjetit. Preventivi përmban: 2 m³ beton C16/20 dhe 37.50 m³ beton C20/25 në një segment; 18 m³ C16/20 dhe 59.60 m³ C20/25 në një segment tjetër; 10 m³ C16/20 + 0.30 m³ C20/25; 12 m³ C16/20 + 0.60 m³ C20/25; shumë zëra të tjerë 2–10 m³ të shpërndarë nëpër zonat e rrjetit. Gjithashtu janë parashikuar zëra të posaçëm për beton C20/25 për mbështetjen e rakorderive me sasi 4.80 m³, 8 m³ dhe 27.20 m³ në segmente të ndryshme. Këto punime janë të fragmentuara dhe shpesh realizohen larg frontit kryesor të depozitës, ndaj përdorimi i një autobetoniere për çdo sasi të vogël nuk është gjithmonë organizativisht i përshtatshëm.

Betonierja e kantierit 0.25 m³ është e përshtatshme për përgatitjen e sasive të vogla të betonit dhe llaçit për punime lokale, mbështetje rakorderish dhe ndërhyrje ndihmëse. Në përcaktimin e pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit, Autoriteti Kontraktor është mbështetur në natyrën e punimeve, sasitë e tubacioneve PE 100 RC, numrin dhe dimensionet e rakorderive elektrofuzive, volumin e punimeve të betonit dhe betonarmesë, shtrirjen territoriale të rrjetit, si dhe nevojën për kryerjen e kontrolluar të montimit, pozicionimit, testimit dhe vënies në funksion të rrjetit. Objekti përfshin linja kryesore, linjë unazore dhe një numër të madh linjash shpërndarëse, si dhe ndërtimin e rezervuarit të ri 6,000 m³. Për rrjedhojë, pajisjet e kërkuara janë përcaktuar si kapacitet minimal teknik për realizimin e këtyre proceseve në disa fronte pune.

Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Electro Fusion” – 3 copë- Kërkesa për disponimin e 3 (tre) aparaturave për bashkimin e tubacioneve me metodën “Electro Fusion” lidhet drejtpërdrejt me një numër shumë të madh rakorderish elektrofuzive të parashikuara në preventiv. Në linjat kryesore parashikohen, ndër të tjera: flanaxha adaptor elektrofuzive DN 400 – 5 copë; DN 110 – 1 copë; DN 400 – 2 copë; DN 200 – 1 copë; DN 160 – 3 copë; DN 125 – 1 copë; DN 90 – 1 copë. Në linjën unazore numri është edhe më i konsiderueshëm, ku vetëm në një pjesë të preventivit parashikohen: 16 copë DN 400; 12 copë DN 315; 4 copë DN 200; 9 copë DN 160; 2 copë DN 125; 11 copë DN 110; 4 copë DN 90.

Krahas tyre, në linjat shpërndarëse parashikohen në mënyrë të përsëritur adaptorë elektrofuzivë për diametra të vegjël dhe të mesëm. Për rrjedhojë, aparatura “Electro Fusion” është pajisje që lidhet drejtpërdrejt me teknologjinë e montimit të rakorderive të preventivuara. Numri prej 3 copësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë shtrirjen e rrjetit dhe mundësinë e zhvillimit paralel të montimit në linjën kryesore, linjën unazore dhe linjat shpërndarëse, duke shmangur transferimin e vazhdueshëm të së njëjtës pajisje ndërmjet fronteve.

Aparat saldimi për bashkimin e tubave kokë më kokë – 3 copë- Kërkesa për 3 (tre) aparate saldimi për bashkimin e tubave kokë më kokë lidhet me sasitë shumë të mëdha të tubacioneve PE 100 RC të parashikuara në preventiv. Në linjën e dërgimit parashikohen 2,401 ml tub PE100 RC DN 400, ndërsa në linjën kryesore rezultojnë, ndër të tjera, 1,157 ml DN 400 dhe 2,879 ml DN 450. Në linjën unazore parashikohen 638 ml DN160, 2,721 ml DN200, 906 ml DN315 dhe 2,604 ml DN400. Preventivi parashikon gjithashtu rakorderi për tub HDPE “me saldim DN 450 mm”, duke konfirmuar përdorimin e teknologjisë së saldimit në sistemin e tubacioneve.

Për diametrat e mëdhenj dhe gjatësitë e konsiderueshme të tubacioneve PE, saldimi kokë më kokë përbën proces teknologjik të lidhjes së elementeve të linjës, sipas kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike. Kërkesa për 3 aparate lidhet me nevojën për të mundësuar realizimin paralel të tubacioneve në disa fronte, veçanërisht duke konsideruar gjatësitë e mëdha të linjave dhe numrin e madh të bashkimeve që rrjedh prej tyre.

GPS/Total Station – 2 copë Kërkesa për 2 (dy) pajisje GPS/Total Station lidhet me karakterin linear, shtrirjen territoriale dhe kërkesën për pozicionim të saktë planimetrik dhe altimetrik të rrjetit. Objekti përmban mijëra metra linearë tubacionesh në diametra të ndryshëm, të shpërndarë ndërmjet linjës së dërgimit, linjës kryesore, linjës unazore dhe shumë zonave të rrjetit shpërndarës. Vetëm linjat kryesore përfshijnë mijëra metra tuba DN400 dhe DN450, ndërsa rrjeti unazor përmban mijëra metra të tjerë DN160–DN400.

Në realizimin e një rrjeti të kësaj natyre është e nevojshme të kontrollohen: aksi i tubacionit; pikat e kthesave; pozicionet e pusetave dhe rakorderive; kuotat e gërmimit; pozicionimi i objekteve hidraulike; lidhja ndërmjet segmenteve të rrjetit; dokumentimi i pozicionit faktik të punimeve të realizuara. Kërkesa për 2 pajisje lidhet me shtrirjen e objektit dhe mundësinë e kontrollit topografik paralel të të paktën dy fronteve të punës.

Nivelues topografik me lazer – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) nivelues topografik me lazer lidhet me kontrollin e kuotave gjatë: gërmimit të kanaleve; vendosjes së tubacioneve; realizimit të shtresave të mbushjes; nivelimit të bazamenteve; realizimit të rezervuarit dhe objekteve të tjera hidraulike. Preventivi përmban volume të konsiderueshme gërmimesh në kanale, ku vetëm në segmente të veçanta rezultojnë 9,766 m³, 7,260.70 m³, 5,338 m³, 4,621.40 m³ dhe 4,368.30 m³ gërmime mekanike. Kontrolli i kuotës së fundit të kanalit dhe i nivelit të shtresave është i domosdoshëm për vendosjen korrekte të tubacionit dhe për shmangien e devijimeve nga profili i projektuar.

Tokmak elektrik – 2 copë- Për 2 (dy) tokmakët elektrikë, lidhja me preventivin është plotësisht e drejtpërdrejtë. Në preventiv gjendet zëri: “Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, çdo 30 cm, tokë të zakonshme”. Sasitë përfshijnë, ndër të tjera: 91 m³; 169 m³; 408.20 m³; 479 m³; 709.20

m³; 138.60 m³ dhe volume të tjera në zona të ndryshme. Gjenerator/Motogjenerator – 4 copë- Kërkesa për 4 (katër) gjeneratorë/motogjeneratorë lidhet me nevojën për furnizim të pavarur me energji elektrike të pajisjeve të punës në fronte lineare dhe të shpërndara ku nuk mund të garantohet furnizim i vazhdueshëm nga rrjeti elektrik. Pajisjet e parashikuara për realizimin e kontratës përfshijnë: aparatura elektrofuzioni; aparate saldimi të tubacioneve; tokmakë elektrikë; elektrosaldatrice; pajisje dhe vegla elektrike ndihmëse.

Vetë preventivi parashikon numër të konsiderueshëm rakorderish elektrofuzive në linjën kryesore, unazore dhe rrjetet shpërndarëse, përfshirë DN400, DN315, DN200, DN160, DN125, DN110 dhe DN90. Meqenëse këto punime zhvillohen në terren dhe në zona të ndryshme, motogjeneratori siguron autonominë energjetike të brigadave. Numri 4 copë është lidhur me organizimin e disa fronteve paralelisht — tubacionet kryesore, rrjeti unazor dhe rrjetet shpërndarëse — si dhe me nevojën për rezervë/furnizim të pajisjeve ndihmëse.

Vibrator betoni – 4 copë- Kërkesa për 4 (katër) vibratorë betoni lidhet veçanërisht me volumin dhe karakterin e punimeve betonarme për rezervuarin e ri 6,000 m³. Preventivi parashikon: 1,052 m³ C30/37 për pllakën; 582 m³ për muret 40 cm; 419 m³ për muret 50 cm; 345 m³ për soletën; 86 m³ për trarët; 83 m³ për kolonat; 75 m³ për krijimin e pjerrësive. Këto zëra japin gjithsej 2,642 m³ beton C30/37 vetëm për rezervuarin. Struktura është gjithashtu e armuar në mënyrë të konsiderueshme, pasi preventivi parashikon 80 ton hekur Ø6–10 mm dhe 255 ton hekur Ø>12 mm, pra gjithsej 335 ton armaturë. Në këto kushte, vibratorët janë të nevojshëm për kompaktimin e betonit, eliminimin e boshllëqeve dhe sigurimin e mbushjes së duhur të hapësirave ndërmjet armaturave, veçanërisht në mure, trarë dhe kolona. Numri prej 4 copësh lidhet me volumet e larta të betonimit, përmasat e strukturës dhe nevojën për vazhdimësi të procesit, duke mundësuar punën me më shumë se një pikë vibrimi dhe disponimin e pajisjeve gjatë betonimeve masive.

Aparat për kryerjen e testeve të presionit të linjave të ujësjellësit – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) aparat për testimin e presionit lidhet me vetë natyrën funksionale të objektit: ndërtimin e një rrjeti ujësjellësi nën presion. Preventivi përmban tubacione PE100 RC në presione nominale PN10 dhe PN16, si dhe rakorderi, valvula dhe elemente gize PN16. Për shembull, në linjën kryesore dhe unazore parashikohen mijëra metra PE100 RC në diametra DN90–DN450. Preventivi gjithashtu përmban pajisje ku presioni është parametër funksional, përfshirë valvul kontrolli dhe reduktim presioni me Pmax 10 bar dhe presion të reduktuar 8.5 bar. Testimi hidrostatik i seksioneve pas montimit shërben për verifikimin e: hermeticitetit të bashkimeve; qëndrueshmërisë së tubacionit; rakorderive; valvulave; elementeve të montuar nën presion.

Elektrosaldatrice/Motosaldatrice – 2 copë- Kërkesa për 2 (dy) elektrosaldatrice/motosaldatrice lidhet me punimet metalike dhe instalimet e elementeve prej çeliku të parashikuara në preventiv. Në shumë zona preventivi përmban zërin “F.V. Tuba çeliku Ø~200 mm”, me sasi: 340 kg; 1,042 kg; 680 kg; 1,250 kg; 1,500 kg; Për depon parashikohen gjithashtu: 126 ml trarë metalikë IPE 160; 24 ml trarë IPE 160 për shkallë; 141 m² dysHEME metalike me zgarë të zinkuar; 20 ml shkallë inoksi. Gjithashtu parashikohen 193 ml konstrukcion kangjellash me profile hekuri. Këto punime kërkojnë operacione montimi dhe lidhjeje të elementeve metalike, për të cilat

elektrosaldatricja/motosaldatricja është pajisje funksionale e kantierit. Kërkesa për 2 copë lidhet me mundësinë e realizimit paralel të punimeve metalike në rezervuar dhe punimeve në rrjet.

Fabrikë betoni e pajisur me lejen mjedisore përkatëse – 1 copë, në pronësi/qira ose kontratë furnizimi- Kërkesa për sigurimin e 1 (një) fabrike betoni, qoftë në pronësi, me qira ose nëpërmjet kontratës së furnizimit, është një nga kërkesat që ka mbështetje të fortë në volumet e preventivit.

Vetëm për rezervuarin e ri parashikohen 2,642 m³ beton C30/37 për elementet kryesore strukturore. Në preventiv ekziston gjithashtu zëri i posaçëm: “Transport betoni me autobetonjere 10.0 km” – 2,977 m³ vetëm për depon e re. Përveç këtij volumi, parashikohen transporte të tjera të betonit: 42.30 m³; 67.60 m³; 230.60 m³; 41.81 m³ etj.

Gjithashtu, në të gjithë rrjetin parashikohen struktura monolite C16/20 dhe C20/25 dhe beton për mbështetjen e rakorderive. Për rrjedhojë, volumi i betonit nuk është sporadik, por përfaqëson një komponent të rëndësishëm të objektit. Furnizimi i këtij volumi kërkon burim të organizuar dhe të vazhdueshëm prodhimi, me kapacitet për të garantuar furnizim të njëtrajtshëm gjatë betonimeve strukturore. Lejimi i alternativave “në pronësi, me qira ose me kontratë furnizimi” e bën kriterin proporcional, pasi operatori ekonomik nuk detyrohet të zotërojë vetë një fabrikë betoni; ai mund ta sigurojë kapacitetin e nevojshëm përmes një subjekti furnizues. Në përcaktimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme, Autoriteti Kontraktor ka marrë në konsideratë natyrën e objektit, volumin e punimeve të gërmimit, betonit, punimeve elektrike, ndërtimin e rezervuarit të ri 6,000 m³, shtrirjen e rrjetit në disa fronte pune dhe nevojën për sigurimin e kushteve teknike dhe organizative gjatë zbatimit të kontratës.

Pompë uji – 3 copë- Kërkesa për disponimin e 3 (tre) pompave të ujit lidhet me natyrën e punimeve të gërmimit dhe ndërtimit të veprave hidraulike, ku gjatë hapjes së kanaleve dhe gërmimeve për rezervuarin dhe pusetat mund të jetë e nevojshme largimi i ujërave sipërfaqësore, infiltrimeve apo ujërave të grumbulluara në gropat e punës. Preventivi përmban volume shumë të larta gërmimi mekanik. Vetëm në disa nënobjekte parashikohen 9,766 m³, 7,260.70 m³, 5,338 m³, 4,621.40 m³ dhe 4,368.30 m³ gërmime, si dhe një numër të madh pusetash dhe strukturash nëntokësore. Në zonën e rezervuarit parashikohen gjithashtu puseta shkarkimi, puseta shiu dhe një pusetë betonarme 200×200 cm, h=250 cm. Për këto punime, prania e ujit në gropën e gërmimit mund të pengojë vendosjen e tubacioneve, realizimin e shtresave dhe betonimin. Pompat e ujit shërbejnë për mbajtjen e frontit të punës të thatë dhe të punueshëm. Numri prej 3 pompash lidhet me mundësinë e zhvillimit paralel të punimeve në disa zona të rrjetit.

Armaturë – 1,000 m²- Preventivi për ndërtimin e depos së re 6,000 m³ përmban seksionin “Punime skele dhe kallëpi”, ku parashikohen konkretisht 1,200 m² skelë metalike deri në 10 m. Gjithashtu, struktura e rezervuarit përfshin: 1,052 m³ beton C30/37 për pllakën; 582 m³ mure t=40 cm; 419 m³ mure t=50 cm; 345 m³ soletë; 86 m³ trarë; 83 m³ kolona. Për realizimin e mureve, kolonave, trarëve dhe soletës nevojiten sisteme kallëpimi dhe mbështetjeje të përshtatshme. Kjo kerkese nënkupton pikërisht kallëpin/armaturën e përkohshme, sasia 1,000 m² është në raport me zërin e preventivit prej 1,200 m² skelë metalike, duke përfaqësuar një kapacitet të përafërt operacional për realizimin e punimeve strukturore.

Matrapik – 1 copë- Kërkesa për 1 (një) matrapik lidhet drejtpërdrejt me zërat e shumtë të prishjeve të parashikuara në preventiv.Në preventiv rezultojnë:75 m³ prishje struktura prej betoni në zonën e depos; prishje shtresa betoni; prishje muresh betoni; prishje muresh me blloqe; prishje muresh tulle; prishje të shtresave të betonit në rrugë dhe trotuare. Për realizimin e këtyre zërave në mënyrë të kontrolluar, veçanërisht në zona ku nuk mund të përdoret makineri e rëndë, matrapiku është pajisje e përshtatshme për prishjen mekanike të betonit dhe elementeve murature. Kërkesa për 1 copë konsiderohet proporcionale me karakterin plotësues të pajisjes.

Testues instalimesh multifunksional – 1 copë-Kërkesa për 1 testues multifunksional të instalimeve elektrike lidhet me punimet elektrike dhe sistemet e komandimit të parashikuara në preventiv për depon dhe sistemin SCADA.Preventivi përmban, ndër të tjera:100 ml linjë kablllore bakri 5×6 mm²; 1 kuadër elektrik të depos; 1 panel komandimi për ndriçimin; 25 kuadro elektrike të pushtave; 1,250 ml kabllo bakri TU 3×2.5 mm²; 25 panele diellore me kontrollues dhe bateri; sisteme tokëzimi dhe mbrojtjeje. Në një objekt ku përfshihen kuadro, kabllo, sisteme komandimi, tokëzim dhe pajisje elektronike, testimi i instalimit pas montimit është i nevojshëm për verifikimin e parametrave bazë të sigurisë dhe funksionimit.Për rrjedhojë, testuesi multifunksional lidhet me kontrollin teknik dhe vënien në funksion të instalimeve elektrike të preventivuara.

Matës izolacioni – 1 copë-Kërkesa për 1 matës izolacioni lidhet gjithashtu me volumin dhe llojin e instalimeve elektrike.Preventivi përmban:kabllo kontrolli Cu të armuar në tokë 4×2.5 mm² – 70 ml; linjë kablllore bakri 5×6 mm² – 100 ml; kabllo bakri 3×2.5 mm² – 1,250 ml; përçues mbrojtës me seksione të ndryshme; sisteme tokëzimi dhe rrufepritëse; kuadro elektrike.

Matësi i izolacionit nevojitet për verifikimin e rezistencës së izolimit të kablllove dhe qarqeve elektrike pas instalimit dhe përpara energjizimit.

Kontenier ndërtimi stacionar – zyrë, 1 copë-Kërkesa për 1 kontenier stacionar për përdorim si zyrë kantieri lidhet më shumë me organizimin e kantierit sesa me një zë të veçantë preventivi.Objekti është i gjerë dhe kompleks, duke përfshirë:ndërtimin e rezervuarit të ri 6,000 m³; linjën e dërgimit; linjën kryesore; linjën unazore; një numër të madh zonash të rrjetit shpërndarës; instalime elektrike dhe SCADA.

Në këto kushte, një ambient i dedikuar kantieri është i nevojshëm për:administrimin e dokumentacionit teknik; mbajtjen e ditarit të punimeve; koordinimin e personelit teknik; ruajtjen e planeve dhe dokumentacionit; organizimin e takimeve të kantierit; dokumentacionin e sigurisë dhe kontrollit të cilësisë.

Makineri mikrotunelimi horizontal për kalim tubacioni – 1 copë-Preventivi parashikon shumë linja tubacionesh PE dhe gize me diametra të mëdhenj, përfshirë:2,401 ml PE100 RC DN400; 1,157 ml DN400; 2,879 ml DN450; 2,604 ml DN400 në linjën unazore; mijëra metra tubacione të tjera në diametra DN25–DN315.

Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të

perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:*

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese dhe përcjelle për punimet e vepres, duke qenë se specifikimet teknike të përcjella, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Njesia e Prokurimit